

RAPORT  
2007.



## KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Tiranë më 19. 02. 2008

Nr. 87/1 Prot.

Lenda: Dërgohet Raporti i KKRT për vitin 2007

Për: Zonjën Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

**KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

E nderauara zonja Kryetare

Në zbatim të ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998 "Për Radion dhe Televisionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", si edhe shkresës Tuaj nr. 378 prot. Dt. 28.01. 2008, bashkëlidhur po ju sjellim Raportin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2007.

MESILA DODA (DEMI)  
KRYETARE

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT PËR VITIN 2007

|   |
|---|
| <b>1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....</b>   |
| 1.1 Kërkesat e rezolutës së Kuvendit dhe realizimi i tyre.....  |
| 1.2 Struktura e KKRT.....   |
| 1.3 Marrëdhëniet me jashtë.....   |
| 1.4 Marrëdhëniet me publikun.....   |
| <b>2 RREGULLIMI DHE MBIKQYRJA E VEPRIMTARISË RADIO<br/>TELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME<br/>KUADRIN LIGJOR.....</b> |
| 2.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor.....   |
| 2.2 Licensimet.....   |
| 2.3 Mbrojtja e të drejtave të autorit.....  |
| 2.4 Sanksionet ndaj subjekteve.....   |
| 2.5 Çështjet gjyqësore.....   |
| 2.6 Prokurimet e zhvilluara nga KKRT.....   |
| <b>3 PROGRAMACIONI.....</b>   |
| 3.1 Situata programore në media.....  |
| 3.2 Programet informative.....  |
| 3.3 Etika në media.....   |
| <b>4 OPERATORËT RADIO E TELEVIZIVË.....</b>   |
| 4.1 Televizioni publik.....   |
| 4.2 Operatorët kombëtarë.....   |
| 4.3 Operatorët vendorë dhe mbulimi i realizuar.....   |
| 4.4 Mbyllja e transmetimeve jashtë zonës së tyre të licensimit.....   |
| 4.5 Puna përfundimin e planit të frekuencave.....   |
| 4.6 Miratimi i strategjisë të transmetimeve numerike.....   |
| <b>5 BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË.....</b>  |
| 5.1 Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.....   |
| 5.2 Bilancet kontabël të operatorëve radio televizivë.....  |
| 5.3 Gjobat.....   |
| 5.4 Përmirësimi i akteve ligjore e nënligjore në fushën ekonomike.....  |
| <b>6 PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2008.....</b>   |
| <b>7 TABELA FINANCIARE.....</b>   |

## 1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

### 1.1 Kërkesat e rezolutës së Kuvendit dhe realizimi i tyre

Bazuar në ligjin “ Për radion dhe televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë » ne raportojmë para jush mbi veprimtarinë e KKRT gjatë vitit 2007.

Viti 2007 ka qenë një vit i vështirë për KKRT si për sfidat e përballuara, ashtu edhe për vështirësitë e njohura të konstituimit e organizimit. Por rezultatet e arritura qe po i parashtrojmë para jush na bëjnë të konkludojmë se ky vit rezultoi një vit i suksesshëm që ka shënuar një kthesë rrënjesore në rregullimin e mediave elektronike duke vendosur « rregullin e ligjit » dhe duke shtruar rrugën e zhvillimit të qendrueshëm.

Si bazë e punës së KKRT për vitin 2007 kanë shërbyer detyrat e vendosura nga Kuvendi në rezolutën e datës 4 Qershor 2007, ku :

1. I tërhojë vëmendja KKRT-së në drejtim të rritjes së autoritetit të zbatimit të ligjit në mënyrë konstante dhe pa diferencime nga ana e këtij institucioni.
2. Kërkojë Hartimi në një kohë sa më të shkurtër i Planit Kombëtar të Caktimeve Frekuencore, në fushën e transmetimeve analoge dhe numerike.
3. Dhe nxitej reformimi i mëtejshëm ligjor e institucional të KKRT-së, për ta organizuar atë në mënyrë më funksionale dhe sipas të njëjtave parime që organizohen autoritetet rregullatore në të gjitha vendet europiane.

Ndjekja me prioritet e detyrave të mësipërme beri që të arrihen rezultate të menjëherëshme dhe të prekshme të cilat gjetën reflektim edhe në Raportin e Komisionit European për vitin 2007, në të cilën thuhet:

**“ Ka progres në fushën e politikës audio-vizuale. KKRT mori masa rigorozë kundër operatorëve televizive privatë që transmetonin jashtë zonës së tyre të licencimit”.**

Gjatë vitit 2007 jane bërë hapa vendimtarë në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, të cilat jo vetëm siguruan licencimin e operatorit të tretë analog kombëtar, por garantojnë edhe licencimin e operatorëve të parë numerikë. Reformimi i mëtejshëm ligjor e institucional, sipas parimeve të sankzionuara në dokumentet kryesore të komunitetit evropian (aquis communautaire ») , është një punë e cila në vitin 2007 është përmirësuar në përbajtje e cilësi edhe nëpërmjet bashkëpunimit konstruktiv me Ministrinë e integrimit Evropian. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik është në dijeni të të gjithë punës që ka bërë dhe po bën KKRT, për shkak të pjesmarrjes së tij në ndryshimin e ligjit ekzistues për funksionimin e KKRT, hartimit të ligjit për tranmsetimet numerike dhe rregulloreve që po përgatisimin në zbatim të tyre.

## 1.2 Struktura e KKRT

Në periudhën 1 janar – 13 janar 2007, Këshilli funksionoi me përbërjen e tij të plotë, Kryetar, Zëvendëskryetar dhe 3 anëtarë. Mbështetur në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar me ligjin nr. 9677, datë 13.01.2007 neni 8 "Përbërja", numri i anëtarëve të KKRT-së ndryshoi nga 3 në 5. Në periudhën janar – korrik 2007 ka funksionuar me 2 anëtarë më pak. Deri në datë 9 korrik 2007 periudhë KKRT-ja kryesohej nga Z. Ledi Bianku. Pas largimit të tij me dorëheqje nga detyra e kryetarit, funksionin drejtues e ka kryer Znj. Mesila Doda (Demi), si nënkyetare. Me dy vendime të Kuvendit të Shqipërisë - nr. 121, datë 24.09.2007, Znj. Doda (Demi) zgjidhet në detyrën e Kryetares së KKRT-së dhe me vendim nr. 122, datë 24.09.2007 u zgjodhën edhe tre anëtarë të rinj të KKRT-së, duke plotësuar kështu numrin 7. Nga kjo periudhë KKRT ka funksionuar i plotë duke krijuar kushtet për një vendimmarje transparente e të besueshme. Sipas ligjit, KKRT-ja ka të gjitha përgjegjësitë për të ushtruar autoritetin e vet në fushën e transmetimeve radio e televizive. Vendimet e marra gjatë vitit 2007, dëshmojnë për zbatim korrekt e jodiskriminues të këtyre përgjegjësive. Kjo ka sjellë rritjen e autoritetit të KKRT-së dhe uljen e numrit të kundërshtimeve përvendimet lidhur me operatorët radio e televizivë, kombëtarë e vendorë.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, për të rritur kapacitetet administrative të tij, për të zgjidhur në mënyrë të përshtatshme problemet lidhur me transmetuesit privatë radio e televizive, i propozoi Kuvendit ndryshime në strukturën dhe organikën e vet, të cilat u mbështetën nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 66, datë 11.12.2006 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së KKRT-së". Numri i punonjësve nga 34 është rritur në 48. Struktura përbëhet nga pozicionet e punës si më poshtë :

- i. E zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë:  
Kryetare e KKRT-së
- ii. I zgjedhur nga KKRT-ja:  
Zv/kryetari i KKRT-së (1)
- iii. Stafi politik:  
Kabineti (3 vetë)
- iv. Punonjës me status të shërbimit civil 34 vetë:  
Drejtor Drejtorie (6)  
Përgjegjës sektori (7)  
Specialist (21)
- v. Punonjës shërbimi (9).

KKRT-ja, mbështetur në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, zgjedh Këshillin e Etikës, të përbërë nga tre vetë, me status punonjës të jashtëm me honorarë.

Miratimi i strukturës dhe organikës nuk është shoqëruar me kategoritë e pagave për pozicionet e reja të punës. Propozimi i KKRT-së për ndryshimet e paraqitura në strukturë kërkonte që, me rritjen e numrit të punonjësve, të mundësohej zbatimi i politikave të reja që ka ndjekur gjatë viti 2007 dhe po ndjek KKRT-ja. Për këtë janë plotësuar vendet e reja të punës me punonjës me kontratë pune deri në miratimin e plotë të strukturës, të shoqëruar edhe me kategoritë e pagave. Për mënyrën e pagesës së punonjësve KKRT është këshilluar edhe me Departamentin e Administratës Publike. Pagesa është kryer me kategorinë më të ulët për çdo klasë.

Mbështetur në VKM nr. 901, datë 19.12.2007 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nepunësve civilë/nepunësve, nepunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e institucioneve të pavarura" KKRT është duke punuar dhe përgatitur projektstrukturën e plotësuar me kategoritë e vendeve të punës e cila, do t'i kalojë për mendim Ministrisë së Financave dhe DAP-it. Me miratimin e strukturës së rishikuar, KKRT, në zbatim të ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nepunësit civil", do të fillojë procedurat e plotësimit të pozicioneve të reja të punës.

### *1.3 Marrëdhëni me jashtë*

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit e ka vlerësuar të një rëndësie të veçantë forcimin e bashkëpunimit me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, si në nivel dypalësh ashtu dhe shumëpalësh. Për këtë arsy, në strukturën e re, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë (nëntor 2006), u parashikua dhe formalizimi i strukturës përkatëse me synim forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e medias, hartimin e projekteve të ndryshme në këtë fushë dhe paraqitjen e tyre pranë institucioneve apo donatorëve të mundshëm ndërkombëtarë.

Që nga krijimi i kësaj strukture e deri më sot, vërehet një intensifikim i vazhdueshëm i këtyre marrëdhënieve, gjë që është konkretizuar dhe me nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit ose që janë në proces nënshkrimi, në lidhje me aspekte të caktuara të fushës audio-vizuale. Më konkretisht:

Është nënshkuar Memorandumi i Bashkëpunimit me Zyrën e OSBE-së në Tiranë (shtator 2007), që konsiston në mbështetjen e ofruar nga OSBE-ja në nivel ekspertize për hartimin e Strategjisë në fushën e Mediave Elektronike. Aktualisht, për hartimin e kësaj Strategjie në përputhje dhe me Memorandumin e nënshkuar, është atashuar pranë KKRT-së një ekspert nga Autoriteti Audio-Vizual Francez, i përzgjedhur nga Zyra e OSBE-së.

Është duke u punuar për hartimin dhe nënshkrimin e një Protokolli Bashkëpunimi me AGICOM-in (L'autorità per le Garanzie delle Comunicazioni), i cili do të bëjë

të mundur ofrimin e një mbështetjeje të plotë teknike në shumë aspekte të fushës së medias, çka do të jetë një ndihmesë e madhe për përqasjen me standarde të kërkua të ndërkombëtare.

Nisur nga nevoja dhe kërkesa për forcimin e bashkëpunimit edhe me vende të tjera, janë vendosur tashmë urat e bashkëpunimit edhe me Autoritetin Audio-Vizual Francez (CSA – Conseil Supérieur de l'Audiovisuel) dhe është propozuar arritja një marrëveshjeje binjakëzimi, nisur nga përvoja e gjerë franceze në këtë drejtim.

Përfshirja e drejtpërdrejtë si dhe ndihmesa e strukturave ndërkombëtare, si e Komisionit Evropian apo Këshillit të Evropës, si në hartimin e ligjit "Për transmetimet numerike", ashtu dhe në reformën e plotë ligjore që është duke u realizuar, janë pjesë e forcimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, që merr një vlerë të veçantë meqë këto struktura janë vlerësuesit e standardeve që duhet të realizohen në këtë fushë, në përputhje me angazhimet e marra në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian dhe me gjerë.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, nisur nga fakti i të qenit anëtar me të drejta të plota në disa prej organizmave ndërkombëtare në fushën e politikave audio-vizuale, ka vlerësuar gjithmonë nevojën e pjesëmarries aktive në të gjitha veprimtaritë e organizuara prej tyre, me qëllim shkëmbimin e përvojës me vendet e tjera anëtare si dhe përfitimin nga mundësítë që rrjedhin nga anëtarësimi në këto organizata.

I rëndësishëm në këtë drejtim ishte edhe ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë (dhjetor 2007) i ligjit "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radio-Komunikacionit për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesët e rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencave 174-230MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06)", dhe "Mbi ratifikimin e Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radio-Komunikacionit për rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit" (1961).

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, gjatë këtij viti raportues, ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare në këtë fushë, të tillë si EPRA, ITU, Rrjeti i Vendeve Mesdhetare (RIRM) etj, duke qenë aktiv për shfrytëzimin e këtyre takimeve ndërkombëtare në funksion të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe njohjes së përvojave më të mira në këtë fushën e medias.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit ka vazhduar thellimin e bashkëpunimit edhe me organizma të tjera evropiane dhe ndërkombëtarë si Autoriteti Audiovizual Evropian, EBU dhe "Motion Pictures Association".

Duke qenë të vetëdijshëm për nevojën e mbështetjes që ka ky institucion për realizimin e projekteve të ndryshme që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe

përmirësimin e funksionimit të tij, në kuadër të asistencës komunitare IPA (Instrumenti finansiar i paraaderimit) që do të ofrohet në vitet në vazhdim për mbështetjen e procesit të integrimit në Shqipëri, KKRT-ja ka përgatitur një projekt-fishë, që arrin një vlerë prej rreth 1.3 milionë eurosh e që përqendrohet në 4 (katër) shtylla kryesore: - krijimi i një studioje monitorimi "online", për të monitoruar të gjithë territorin e Shqipërisë; - zbatimi i planit të frekuencave; - harmonizimi me standartet evropiane i legjislacionit shqiptar në fushën e medias; - forcimi i kapaciteteve administrative të institucionit.

Duke qenë se realizmi i këtij projekti është i pamundur financiarisht me burimet e brendshme, atëherë u pa e nevojshme mundësia e financimit të tij nga programi IPA. Fakti se deri me sot, KKRT-ja nuk ka përfituar asnjë fond nga projektet komunitare si dhe duke vlerësuar rëndësinë që ka kjo fushë për Shqipërinë dhe vetë Bashkimin Evropian, si pjesë e kritereve politike për anëtarësim, jemi të bindur se ky projekt do të trajtohet me vëmendjen më të madhe nga shërbimet e Komisionit Evropian.

#### *1.4 Marrëdhëniet me publikun*

Një sistem demokratik është me efikas kur publiku është i informuar për çështjet me interes të përbashkët. Informimi i publikut konsiderohet si një nga premisat për suksesin e një qeverisjeje demokratike. Nëpërmjet mënyrave të informimit ndërtohet besimi i publikut tek qeverisja në përgjithësi si dhe tek çdo institucion apo ent rregullator i ngarkuar me drejtimin e një fushe të caktuar të jetës publike.

Marrëdhëniet publike lidhen me të drejtën e individit për të qenë i informuar rreth çështjeve që publikut i interesojnë, por dhe me rrugën ligjore që duhet ndjekur e respektuar për të bërë të mundur që informacioni që përçohet tek publiku të jetë objektiv, serioz dhe korrekt.

Transparenca e vazhdueshme e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit si dhe zhvillimi i një komunikimi ta pandërprerë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, ka qenë dhe mbetet një objektiv primar i këtij institucionit.

Kjo është konstatuar në të gjitha hapat e ndërmarrë në veprimtarinë e KKRT-së, e cila ka synuar dhe synon informimin dhe transparencën me publikun, qartësimin e veprimeve të marra, njohjen me kuadrin ligjor mbi të cilën vepron ky institucion, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të tij, me qëllimin për të shprehur edhe keqkuptimet apo keqdashjet që krijohen herë pas herë, duke synuar për arsyet e interesave të caktuara mediatike apo politike, pengimin e punës së këtij institucioni në ndërmarrjen e veprimeve në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi.

Rasti më tipik që vlen të përmendet këtu është vendimi i KKRT-së për të bllokuar dhe sekuestruar të gjithë transmetuesit e paliçensuar në të gjithë territorin e vendit, si një hap që synonte vendosjen e ligjshmërisë. KKRT-ja, gjatë gjithë kësaj periudhe, për vetë sensibilitetin që publiku ka në raport me median, zhvilloi një fushatë të gjerë komunikimi dhe transparency publike (qoftë nëpërmjet konferencave të shtypit apo njoftimeve të herëpashershme në organet e ndryshme të shtypit) për të sqaruar rëndësinë dhe nevojën e ndërmarrjes së këtyre veprimeve plotësisht ligjore.

Kjo transparencë dhe informim i vazhdueshëm, jo vetëm për publikun e gjerë por edhe për institucionet ndërkombëtare që monitorojnë situatën në Shqiperi në lidhje me ndërmarrjen e këtyre veprimeve ligjore, krijuan opinionin logjik të drejtësisë së këtyre veprimeve. Raporti Vjetor i Komisionit Evropian mbi situatën në Shqipëri (nëntor 2007), pjesa referuar medias, ishte shprehja më e qartë e vlerësimit të transparencës, informimit dhe drejtësisë së veprimeve të marra.

Të njëjtën transparencë dhe komunikim me publikun, KKRT-ja zhvilloi edhe gjatë garës për dhënien e licencës së tretë kombëtare, për të shmangur çdo lloj paragjyktimi apo insinuate ndaj procedurave të ndjekura, nëpërmjet përdorimit të të gjitha mekanizmave të komunikimit dhe transparencës me të gjithë operatorët konkurrues dhe më gjerë. Për herë të parë në historinë e këtij institucioni u bë e mundur ndjekja e një procedure transparente konkurrente publike ku askush nga operatorët në garë nuk kontestuan, në asnjë fazë të zhvillimit, procedurat e ndjekura nga KKRT-ja si dhe vendimin e marrë.

Një nga instrumentet e komunikimit të vazhdueshëm me publikun ka qenë edhe përmirësimi i faqes elektronike të KKRT-së nëpërmjet ndryshimeve përkatëse si në formë dhe në përbajtje, përditësimi të vazhdueshëm të saj, hapjes së rubrikave të reja informative, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë dhe objektiv të veprimtarisë së KKRT-së si dhe marrjes së çdo informacioni të dobishëm nga publiku i gjerë si dhe nga operatorët radio-televizivë.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në kuadër të përmirësimit të komunikimit dhe transparencës me publikun, është duke punuar në hartimin e një Strategjie Komunikimi, e cila synon vendosjen e kontaktave permanente me kategori të ndryshme shoqërore, duke e bërë me efikas dhe transparent rolin që duhet të luajë ky institucion në raport me shtresa të ndryshme shoqërore dhe aktorëve mediatike. Më konkretisht, kjo Strategji Komunikimi do të fokusohet në rritjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me:

- pronarët dhe drejtuesit e mediave audio-vizive;
- analistët dhe gazetaret e shtypit elektronik dhe të shkruar;
- studentët;
- shtresa të ndryshme të shoqërisë.

Një rëndësi të veçantë në këtë strategji do t'i kushtohet forcimit të marrëdhënieve ndërmjet Këshillit të Etikës dhe qytetarëve në funksion të ruajtjes së etikës në transmetimet audio-vizuale dhe respektimit të normave etike dhe ligjore në këtë drejtim.

Zbatimi i plotë i kësaj strategje do të bënte të mundur një pasqyrim më të plotë dhe objektiv të gjithë veprimtarisë dhe funksionimit të KKRT-së në raport me publikun dhe grupet e ndryshme të interesit si dhe në një njohje më të mirë të rëndësisë që ka liria e shprehjes dhe garantimi i saj në një shoqëri demokratike.

Një tjetër projekt, i cili ka filluar të zbatohet dhe që meriton një vëmendje dhe vlerësim të veçantë, është edhe ngritja e një mini –bibliotekë profesionale brenda hapësirave të brendshme të Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizonit. Kjo mini-bibliotekë, e konceptuar sipas modelit të qendrave të dokumentacionit evropian, do të përbajë jo vetëm të gjithë legjislacionin e brendshëm në fushën e mediave por edhe botimet dhe literaturën më të fundit ndërkombëtare në këtë fushë.

Një pjesë të rëndësishme të kësaj mini-bibliotekë do ta zënë aktet e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, të cilët konsiderohen si hartuesit kryesore të standarteve dhe praktikave më të mira evropiane në këtë fushë. Identifikimi, njohja dhe zbatimi i këtij korpusi ligjor, do të konsiderohej si instrumenti kryesor i përshpejtimit të procesit të përafrimt të legjislacionit shqiptar me këto standarde.

Duhet të theksohet që kjo mini-bibliotekë profesionale, do të jetë e shfrytëzueshme jo vetëm nga personeli i KKRT-së, por do t'i jepet akses çdo qytetari apo subjekti të interesuar për këtë fushë nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë burimeve të disponueshme që do të ketë ajo.

Realizimi sa me i shpejt i saj do të ishte një ndihmesë e jashtëzakonshme në punën e përditshme të KKRT-së e njëkohësisht edhe një ndihmesë reale për të gjithë subjektet dhe aktorët e interesuar për të marrë informacion mbi zhvillimet në fushën e medias.

## **2 RREGULLIMI DHE MBIKQYRJA E VEPRIMTARISË RADIO TELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR**

Viti 2007, me shumë se asnjëherë tjetër ka shënuar forcimin e mëtejshëm të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit dhe afirmimin e rolit të tij si autoritet rregulator i veprimtarisë radiotelevizive, nëpërmjet rritjes së strukturës organizative, kapaciteteve manaxhuese, forcimit të lidhjeve ndërinstitucionale dhe përmirësimit të mjeteve e instrumenteve të domosdoshëm për mbështetjen e veprimtarisë.

KKRT gjatë këtij viti ka punuar në përputhje me drejtimet kryesore të përcaktuara nga ligji organik nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative si dhe akte të tjera normative me të cilat rregullohet veprimtaria e KKRT-së.

Qëllimi kryesor i punës së KKRT-së, është rregullimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radiotelevizive publike e private, në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. Konkretisht detyrat kryesore kanë konsistuar në sugjerimin e ndryshimeve të legjislacionit dhe rregulloreve, ndjekjen e procedurave të licencimit të subjekteve radioteleviziv, kontrollin e respektimit të dispozitave ligjore dhe kushteve të licencës nga operatorët, respektimin prej tyre të të drejtave të transmetimit dhe autorit, ndjekjen e proceseve gjyqësore ku KKRT është palë, etj.

Në ndryshim nga vitet paraardhëse, ristrukturimi dhe shtimi i kapaciteteve, ka sjellë një shtrirje të punës dhe përballimin më me efikasitet dhe në kohë të detyrave e objektivave të përcaktuara nga ligji.

Sidoqoftë, nuk mund të anashkalojmë faktin e njojur se, gjatë këtij viti, dhe posaçërisht në periudhën qershor-shtator 2007, KKRT ka pasur edhe një periudhë ku nuk ka mundur të realizojë plotësisht funksionin e saj. Në këtë kohë, Këshilli kishte në përbërje të tij vetëm katër anëtarë, ndërkojë që ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, parashikon që për dhënie e heqje licence dhe miratimin e rregulloreve për dhënien e licencave duhet një kuorum jo më pak se pesë vota pro. E sjellim në vëmendje sa më sipër pasi, si pasojë e kësaj situate erdhën edhe vonesa në arritjen e disa objektivave të KKRT, për përbushjen e të cilave është bërë një punë më e madhe gjatë muajve në vazhdim.

## 2.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor

Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka qenë baza kryesore dhe e vetme, që përcaktonte drejtimet kryesore të politikave të zhvillimit të medias në Shqipëri. Harmonizimi i këtij ligji me teknologjitet e reja, realitetin e tregut dhe përbushjen e detyrimeve që ka Shqipëria nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, ka bërë prioritare kryerjen e një reforme të plotë ligjore.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2007 KKRT, krahas zbatimit dhe realizimit të detyrave dhe objektivave të përgjithshme, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar evidentimit të vakuumeve ligjore përballë evolucionit teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor në sektorin audioviziv, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve përkatëse në fushën e transmetimeve radiotelevizive. Jo vetëm kjo, por edhe problemet e hasura në praktikën e përditshme, si dhe vështirësitë dhe pengesat që ka paraqitur zbatimi i ligjit për veprimtarinë radiotelevizive, janë evidentuar nga Drejtoria Juridike me qëllim përgatitjen e vërejtjeve dhe propozimeve për ndryshime organeve përkatëse.

Përhapja e gjerë e teknologjisë numerike është një nga sfidat e reja të kuadrit ligjor dhe nënligjor të veprimtarisë së medias. Ligji nr. 8410, nuk parashikonte mundësinë e transmetimit të programeve nëpërmjet teknologjisë numerike, duke u bërë barrierë për zhvillimin e këtij sektori. Për plotësimin e këtij boshllëku ligjor, më datë 28.05.2007, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9742 "Për Transmetimet numerike", i cili ka si qëllim përcaktimin e një kuadri rregullues për hyrjen e transmetimeve numerike.

Gjatë vitit 2007, nga Kuvendi i Shqipërisë, nisi edhe reforma e plotë ligjore në fushën e medias me hartimin e një ligji të ri me qëllim jo vetëm përmirësimin e kuadrit ligjor, por edhe përputhjes së legjislacionit tonë në fushën e medias me standartet dhe praktikat më të mira të vendeve evropiane. Nga ana tjeter, mbetet e nevojshme ti jepet zgjidhje problemeve që rrjedhin nga mangësitë e ligjit aktual apo zbatimi jokorrekt i tij, si psh. ndarja e transmetimeve radiotelevizive nga bota e politikës; forcimi i pavarësisë së KKRT-së (duke i rritur pavarësinë financiare); rritja e performancës së televizionit publik (veçanërisht duke ndryshuar mënyrën e financimit); vendosja e marrëdhënieve të qëndrueshme mes sektorit publik e privat etj.

Gjithashtu, KKRT-së, si një prej aktorëve kryesorë të interesuar, i është kërkuar mendim nga Kuvendi dhe ka paraqitur propozimet e veta si për projekt-ligjin e transmetimeve numerike, edhe për draftin aktual të ligjit integral "Për radion dhe televizionin publike e privat në Republikën e Shqipërisë". Këto propozime janë mbështetur në praktikën e deritanishme, ndërkohë që janë ndërthurur edhe me

eksperiencia të ndryshme të marra nga legjislacionet e vendeve të huaja si ai italian, bullgar, polak, anglez etj.

Një nga propozimet kryesore të KKRT-së është shkrirja në një të vetëm i dy ligjeve aktuale nr. 8410 dhe 9742, me qëllim përputhjen e plotë mes tyre dhe lehtësimin e kalimit total në vitin 2012 në transmetim numerik. Ligji i ri duhet të aktivizojë potencialin teknik, ekonomik të medias - si një faktor kyç i shoqërisë së informacionit, duhet të liberalizojë më shumë tregun, të promovojë konkurrencën, krijimin e klimës së duhur të investimeve, por njëkohësisht të konservojë rolin tradicional të radios dhe televizionit në aspektin social, kulturor dhe edukues.

Një ndërmarrje e rëndësishme gjatë këtij viti, në kuadër të përmirësimit të mënyrës së licencimit të operatorëve radiotelevizivë, ka qenë dhe hartimi i akteve nënligjore përkatëse për mbarëvajtjen e transmetimeve radiotelevizive, apo ndryshime në ato ekzistuese. Duke qenë kompetencë direkte e KKRT-së e parashikuar në ligj, hartimi apo ndryshimi i rregulloreve, i ka dhënë mundësi dhe hapësira institucionit që brenda kuadrit ligjor të përmirësojë aktivitetin e saj dhe lehtësojë veprimitarinë e operatorëve.

Kështu, në zbatim të ligjit nr. 9742, datë 28.5.2007, "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", nga një grup pune i ngritur për hartimin e akteve përkatëse nën-ligjore, është punuar dhe përfunduar Rregullorja për licencimin e operatorëve të rrjetit numerik dhe të operatorëve për programet radiotelevizive. Në këtë drejtim KKRT ka bërë maksimumin e mundshëm në përbushje të detyrimeve të ligjit, por duke mbajtur parasysh edhe përafshimin me standartet evropiane. Pas miratimit të kësaj Rregulloreje, KKRT do të jetë në gjendje të nisë procedurat konkuruese për licencimin e operatorëve të parë numerik.

Gjatë këtij viti, u punua edhe për ndryshimin e Rregullores së licensimit të operatorëve kombëtarë. KKRT, me Vendimin nr. 628, datë 03.10.2007 miratoi Rregulloren e re me Kriteret "Për dhënien e licencave për transmetime televizive analoge tokësore në nivel kombëtar". Në bazë të kësaj Rregulloreje dhe kriteret e përcaktuara në të, u realizua në 15.11.2007 gara për licencimin e operatorit të tretë televiziv privat analog kombëtar, që padyshim përbën një arritje tjeter të punës së KKRT-së. Brenda afatit 90 ditor për shqyrtimin e aplikimeve, KKRT në datë 21.01.2008 mori vendimin e licensimit të subjektit "Top Channel TV" si operator kombëtar, pas një konkurrimi me subjektin "TV Vizioni +". Dhënia e kësaj lisenca konsiderohet si një hap tjeter drejt liberalizimit të tregut mediatik, një tregu më të hapur dhe më cilësor në Shqipëri.

Gjithashtu, në zbatim të risive që po sjell KKRT në licencimet e operatorëve të rinj, licencimi i televizioneve privatë kabllorë, ndërrimi apo zgjerimi i zonave të tyre të transmetimit, në ndryshim nga vitet e tjera tashmë bëhet nëpërmjet konkurrimit publik të kandidaturave, në mbështetje të Vendimit nr. 590, datë 04.06.2007 të KKRT-së, duke sjellë kështu një transparencë maksimale tek subjektet e ndryshëm radiotelevizivë të cilët kërkojnë të liçensohen, zgjerohen apo ndërrojnë zonën e tyre të liçensimit. Në lidhje me liçensimin e operatorëve

kabllorë mendohet që gjatë vitit 2008, të bëhen përmirësimë të tjera në Rregullore për qartësimin e procedurave të licencimit të operatorëve kabllorë, meqenëse dispozitat e ligjit nr. 8410, nuk janë shumë të detajuara. Megjithatë përmirësimi i dispozitave të licencimit të operatorëve kabllorë mund të bëhet edhe në ligjin e ri.

## 2.2 Liçensimet

Liçensimi i operatorëve radiotelevizivë është një nga funksionet kryesore të KKRT-së, i cili bëhet në bazë të kërkesave të subjekteve, disponibilitetit të frekuencave dhe në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Gjatë vitit 2007, KKRT ka marrë gjithsej 110 vendime. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve konsiston në shqyrtimin e aplikimeve për licencime, ri-licencime, shqyrtim dokumentacioni dhe gjobash të vëna nga KKRT për subjekte të ndryshëm radiotelevizive.

Për periudhën janar – dhjetor 2007 janë depozituar një numër i konsiderueshëm kërkesash për t'u liçensuar, për rinnovime liçensash si dhe për zgjerime zonash transmetimi. Një numër të konsiderueshëm të këtyre kërkesave e zënë televisionet kabllore.

Gjatë vitit 2007, KKRT ka liçensuar gjithsej 4 subjekte radiotelevizivë, nga të cilët: 1 për transmetim televiziv vendor, 2 subjekte për televizion kabllor dhe një subjekt për transmetim radio vendore. Këto subjekte janë:

- TV vendor Tele Joni (Himarë – Sarandë)
- TV kabllor TV Kamëz (Kamëz)
- TV kabllor Biliشت (Bilişt)
- Radio vendore B-94 (Tiranë)

Në përputhje me ligjin nr. 8410 datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 7 pikë 5 vendimet e KKRT për dhënien dhe heqjen e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar dhe një numër i konsiderueshëm kërkesash për rinnovim licence, 29 subjekte, në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 si dhe duke ndjekur dhe zbatuar procedurat e përcaktuara në Rregulloren “Mbi procedurat e ri-licencimit të operatorëve radiotelevizivë” dhe kriteret kryesore gjatë rinnovimit të licencave.

Subjektet të cilëve i'u është rinnovuar licenca janë si më poshtë:

- Radio “Ngjallja”
- Radio “Saranda”

- Radio "Top Gold"
- Radio "Club FM"
- Radio "Radio ime"
- Radio "Magic star"
- Radio "Alfa @ Omega"
- Radio "Fieri"
- Radio "Scorpion"
- Radio "Muzika Jonë"
- Radio "Val' e kaltër"
- Radio "Rash"
- Radio "Energy"
- Radio "Alpo"
- Radio "Top Albania"
- Radio "Klea"
- Radio "Nacional A.H"
- Radio "Alfa"
- Radio "Kontakt"
- TV vendor "Tv Lobi"
- TV vendor "Tv Rozafa"
- TV vendor "News 24"
- TV vendor "TV Margit"
- TV vendor "TV Supersonic"
- TV vendor "Antena Nord"
- TV kabllor "TV Irla"
- TV kabllor "Trio Cabille"
- Radio "Aldo 03"
- Radio "Emanuel"

Krahas vendimeve të mësipërme për dhënie dhe rinovime licencash, KKRT, mbështetur në kompetencën kryesore për kontrollin e veprimtarisë radio televizive, ka marrë vendime për heqje, mosrinovime, apo mos dhënie lëçnese për disa subjekte te cilat nuk kanë respektuar kushtet dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe licencë.

- Heqje licence:
  - TV "Johaniter"
  
- Mosrinovime dhe pavlefshmëri licence:
  - TV "Asparag"
  - Radio "New planet"
  - Radio "Real"
  - Radio "Planet"
  - Radio "Magjic"

- TV "Sky"
- TV Përsërítës RAI

■ Mos dhënie licenze:

- |              |                |
|--------------|----------------|
| • TV         | "Info Shkodra" |
| • TV vendor  | "Parma Saralb" |
| • Radio      | "Kiss"         |
| • Radio      | "Take 5"       |
| • TV kabllor | "Roskoveci"    |
| • TV kabllor | "Maqellara"    |
| • Radio      | "Pro Albania"  |

Problemet që janë hasur gjatë proceseve të licensimit apo edhe ri-licensimit janë mosplotësimi i saktë i dokumentacionit për aplikim, fakt që nxjerr si detyrë për vitin e ardhshëm lehtësimin dhe saktësimin e mënyrave të aplikimit apo plotësimit të dokumentacionit.

✓ Është konstatuar gjithashtu, se përsa i përket procedurave të ri-licensimit, shumë operatorë nuk janë të vëmendshëm për afatin që parashikon ligji (90 ditë para përfundimit të licensës) për paraqitjen e kërkesës për ri-licensim, megjithë rritjen e kërkesës nga ana jonë për respektimit e të gjithave afateve që parashikon ligji.

Një ndër drejtimet kryesore të punës së KKRT ka qenë dhe mbetet kontrolli i respektimit të kushteve të përcaktuara në ligj dhe në licencë nga ana e subjekteve radiotelevizivë. Në përgjithësi, duhet thënë se operatorët nga viti në vit ndërgjegjësohen edhe më shumë për detyrimin e tyre karshi ligjit dhe autoritetit të entit rregullator.

Megjithëse ka edhe shumë subjekte që vazhdojnë të kryejnë shkelje të ndryshme, ku ndër më të hasurat janë pirateria e programeve, dalja në transmetim pa licencë, transmetimi në frekuencia të paautorizuara, mosnjoftimi i ndryshimeve, mospagimi i detyrimeve financiare me pasojë pavlefshmërinë e licencës, etj.

✓ Në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, realizuar kjo në bashkëpunim me drejtoret e tjera të administratës së KKRT-së, ndaj subjekteve radiotelevizivë kundravajtës janë ndërmarrë sanksionet përkatëse.

✓ Një detyrim tjetër ligjor, i cili është edhe një ndër kushtet e licencës për subjektet radiotelevizivë, është dhe "Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve". Bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizonin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, parashikohet se:

"I licensuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë, duke dhënë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve. Nëse ndryshimet merren parasysh, shpenzimet përkatëse i paguan i interesuar".

Në rastet kur këto ndryshime nuk janë depozituar brenda afatit ligjor që parashikohet, në mbështetje të nenit 137/4 të ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, janë vendosur sanksionet përkatëse me gjobë.

Lidhur me këtë detyrim ligjor, të gjithë subjekteve i'u është térhequr vazhdimesht vëmendja, me qëllim që në të ardhmen, për çdo ndryshim të dhënave që mund të ndodhin në kërkesën për licencë (sidomos për sa i përket ndryshimeve të pronësisë që mund të kryhen nga subjektet pranë Regjistrat Tregtar), ato të depozitohen në KKRT, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve.

Krahas kësaj, gjatë vitit 2007, në mënyrë periodike si dhe për të bërë verifikimin e herëpashershëm të gjendjes së subjekteve, KKRT i është drejtuar me kërkesën për informacion Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit (QKR), në mënyrë që veprimtaria e subjekteve radiotelevizivë në këtë aspekt të ndiqet në vazhdimësi.

Ndryshimet e pronësisë janë shumë të rëndësishme në kuadrin e mbrojtjes së konkurrencës dhe krijimit të monopoleve, por edhe se shpesh herë ndryshimet e pronësisë rezultojnë në ndryshime në natyrën e operatorëve. Për këtë, do të ishte e nevojshme që në ndryshimin e ligjit të parashikohen detyrime më të sakta dhe të forta për operatorët për kohën dhe mënyrën e njofimit, të përmirësohen procedurat e licencimit dhe ri-licencimit në mënyrë që të analizohet pronësia e aplikantëve jo vetëm e aksionerëve të drejtëpërdrejtë, por edhe atyre indirektë, etj.

### 2.3 Mbrojtja e të drejtave të autorit

Në zbatim të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të", për herë të parë ka filluar të funksionojë si strukturë më vete sektori juridik i të drejtave të autorit (transmetimit), sektor ky që ka si qëllim jo vetëm mbrojtjen e këtyre të drejtave, por edhe parandalimin dhe zhdukjen e fenomenit të "piraterisë radiotelevizive".

KKRT, mbështetur në të drejtën dhe detyrimin ligjor që ka në kontrollin e veprimtarisë së radiotelevizive, ka kërkuar nga subjektet televizivë shqiptarë dokumentacionin që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve të ndryshme radiotelevizive, si filmave artistikë shqiptarë e të huaj, evenimente artistike, sportive, filmave dokumentarë, telenovelave, informacioneve nga vendi e bota, të cilat transmetohen në territorin shqiptar.

Gjatë këtij procesi janë vënë re shkelje të së drejtës së transmetimit nga operatorë të ndryshëm, njëkohësisht janë identifikuar edhe raste të distributorëve jo-ekzistentë (fiktivë). Në të gjitha këto raste, KKRT ka reaguar me vendosjen e sanksioneve të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2007, KKRT, ka intensifikuar punën për ndërgjegjësimin e subjekteve radiotelevizivë mbi të drejtat e detyrimet që kanë në transmetimin e programeve të ndryshme, si të blera ashtu dhe të prodhuara nga ata vetë.

Gjithashtu, KKRT ka kërkuar edhe nga subjektet radiofonikë akt marrëveshje ose kontrata për shfrytëzimin nga ana e tyre të materialeve të ndryshme muzikore e informative. Pavarësisht nga problemet që janë hasur një pjesë e mirë e këtyre subjekteve, kanë depozituar në KKRT dokumentacionin që vërteton të drejtat e transmetimit.

Për vitin 2008, është parashikuar të thellohet puna në këtë drejtim, edhe pse realisht monitorimi i subjekteve radiofonikë është mjaft i vështirë. Vështirësitet janë rrjedhojë e mungesës së monitorimit direkt të subjekteve radiofonikë, e lehtësisë së gjetjes dhe piratimit të materialeve muzikore, ndërgjegjësimit të ulët të këtyre subjekteve për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe rëndësinë e saj, etj.

Gjatë këtij viti është përmirësuar baza përkatëse e të dhënave, në të cilën hidhen të gjithë elementët e kontratave të operatorëve radiotelevizivë me distributorë të ndryshëm, duke bërë kështu të mundur verifikimin dhe kontrollin në vijimësi të legjitimitetit dhe zbatimit të tyre.

Një drejtim tjetër i punës për të drejtën e autorit ka qenë bashkëpunimi me institucione dhe struktura të tjera shtetërore për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të". Në këtë kuadër, gjatë 2007 KKRT ka institucionalizuar bashkëpunimin me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, nëpërmjet nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi e mirëkuptimi, më 28.09.2007.

Qëllimi i këtij Memorandumi bashkëpunimi është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit për implementimin dhe përmirësimin sa më të përshpejtuar, të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", për të vendosur nën kontroll të gjithë tregun e pronësisë të produktit intelektual në fushën e artit, kulturës dhe shkencës, dhe transmetimeve radiotelevizive për të monitoruar dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në luftën kundër piraterisë, falsifikimit dhe respektimit të të drejtave të autorit.

Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, është në vazhdimi bashkëpunimi konkret për parandalimin e piraterisë në transmetimin e filmave artistik shqiptar.

KKRT, në kuadër të përpjekjeve për eliminimin e transmetimeve pirate, në bashkëpunim edhe me institucionet e lartpërmendura, ka krijuar kontakte me distributorë që operojnë në territorin e Shqipërisë, për të verifikuar burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës apo vërtetësisë dhe legjimitetit të kontratave.

Ky aspekt i punës së KKRT-së është mjaft i vështirë, pasi sot për sot mungon infrastruktura e plotë e krijimit të marrëdhënieve të tilla. Një ndihmë e madhe në këtë aspekt, pritet të sigurohet nga Zyra Shqiptare për të Drejtë e Autorit, pasi bazuar në ligj, ky është institucioni përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e të drejtave të autorit në Republikën e Shqipërisë.

Megjithatë po bëhen përpjekje për të krijuar lidhje me qendra të ndryshme distributore të njohura nga BE apo institucione të tjera ndërkombëtare, të cilat mendojmë se gjatë këtij viti do të realizohen, dhe KKRT do të jetë në gjendje të njohë burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Pavarësisht vështirësive, KKRT me punën e saj ka arritur gjatë këtij viti të ulë në një masë të madhe fenomenin e piraterisë tek operatorët radiotelevizivë, dhe pothuajse të eliminojë transmetimet e paligjshme nga operatorët televizivë kombëtarë dhe ata kryesorë vendorë, të cilët janë edhe televizione të monitorueshme direkt nga qendra e monitorimit të KKRT-së.

Ndër faktorët që ndikojnë në vështirësinë e KKRT-së për zhdukjen e këtij fenomeni mund të përmendim:

- Ndërgjegjësimin ende të ulët të operatorëve radiotelevizivë vendorë e kabllorë në zona të thella të vendit në respektimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore për të drejtat e transmetimit;
- Mundësitet jo të duhura teknike të KKRT-së.

Ka operatorë vendorë e kabllorë, të cilët nuk kontrollohen dhe monitorohen direkt nga studio e monitorimit të KKRT-së, fakt i cili e vështirëson punën në aspektin e respektimit të së drejtës së autorit dhe e bën pothuajse të pamundur garantimin e kësaj të drejte në të gjithë territorin.

Pirateria ekziston në një masë më të konsiderueshme tek subjektet që operojnë në zona të thella, dhe që janë larg mbikëqyrjes e monitorimit të KKRT. Monitorimi dhe ndjekja e tyre me sondazhe, sanksionet e ndërmarra dhe publikimi i tyre nuk është i mjaftueshëm për zhdukjen e piraterisë në fushën e transmetimeve radiotelevizive, në të gjithë operatorët.

## 2.4 Sanksionet ndaj subjekteve

Sanksionet e vendosura ndaj subjekteve radiotelevizivë për vitin 2007 janë si më poshtë:

| Nr. | Subjekti              | I Licënsuar   | Numri i gjobës | Data       | Vlera (mijë lekë) | Paguar                                | Data e pagesës | Ndryshime |
|-----|-----------------------|---------------|----------------|------------|-------------------|---------------------------------------|----------------|-----------|
| 1   | TV Klan               | I Licënsuar   | 159            | 08.01.2007 | 100               | 100                                   | 15.01.2007     |           |
| 2   | Radio +2              | I Licënsuar   | 160            | 08.01.2008 | 100               |                                       |                |           |
| 3   | TVA                   | I Licënsuar   | 161            | 08.01.2009 | 100               | 98.8                                  | 10.05.2007     |           |
| 4   | TV Rozafa             | I Licënsuar   | 162            | 26.01.2007 | 500               | Hequr me VKKRT nr.571, dt. 13.03.2007 |                |           |
| 5   | TV Telesport          | I Licënsuar   | 163            | 26.01.2007 | 800               | Ulur me VKKRT nr. 578, dt. 27.04.2007 |                |           |
|     |                       |               |                |            | 60                | 60                                    | 24.05.2007     |           |
| 6   | TV News 24            | I Licënsuar   | 164            | 26.01.2007 | 500               | 500                                   | 29.01.2007     |           |
| 7   | TV Shkodra            | I Licënsuar   | 165            | 31.01.2007 | 300               | 300                                   | 14.05.2007     |           |
| 8   | TV Arbëria            | I Licënsuar   | 166            | 06.02.2007 | 300               | 298.8                                 | 10.05.2007     |           |
| 9   | TV Rozafa             | I Licënsuar   | 167            | 29.03.2007 | 300               |                                       |                |           |
| 10  | TV Lezha              | I Licënsuar   | 168            | 29.03.2007 | 200               | Hequr me VKKRT nr.589, dt. 04.06.2007 |                |           |
| 11  | TV kab. Memaliaj      | I Licënsuar   | 169            | 19.04.2007 | 200               |                                       |                |           |
| 12  | TV 6 + 1              | I Licënsuar   | 170            | 09.10.2007 | 500               |                                       |                |           |
| 13  | TV kabllor Vora,      | I Paliçënsuar | 171            | 09.10.2007 | 300               | 300                                   | 18.12.2007     |           |
|     | TV Sukthi, TV Marikaj | Kabllor       |                |            |                   |                                       |                |           |
| 14  | TV kabllor Himara     | I Paliçënsuar | 172            | 24.10.2007 | 100               |                                       |                |           |
| 15  | TV kabllor Selenica   | I Paliçënsuar | 173            | 24.10.2007 | 100               | Hequr me VKKRT nr.650, dt.12.11.2007  |                |           |
| 16  | TV kabllor Orikumi    | I Paliçënsuar | 174            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 01.11.2007     |           |
| 17  | TV kabllor Divjaka    | I Paliçënsuar | 175            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 29.10.2007     |           |
| 18  | TV kabllor Ksamili    | I Paliçënsuar | 176            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 12.11.2007     |           |
| 19  | TV kabllor Këlcyrat   | I Paliçënsuar | 177            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 12.11.2007     |           |
| 20  | TV kabllor Dushku     | I Paliçënsuar | 178            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 13.12.2007     |           |
| 21  | TV kabllor Shëngjini  | I Paliçënsuar | 179            | 24.10.2007 | 100               | 100                                   | 25.10.2007     |           |
|     | Totali                |               |                |            | 3460              | 2257.6                                |                |           |

## 2.5 Çështjet gjyqësore

Ashtu si vitet e kaluara dhe gjatë vitit 2007, KKRT ka qenë palë e paditur në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme, ku pjesën më të madhe e zënë konfliktet me operatorë të ndryshëm radiotelevizivë. Një pjesë e këtyre çështjeve janë të trashëgaura nga vitet paraardhëse, por si pasojë e zvarritjeve të gjata dhe të pajustifikuara nga ana e gjykatave, ka bërë që gjykimi i tyre të vazhdojë dhe gjatë vitit 2007.

Aktualisht, KKRT është e përfshirë në total në 27 procese gjyqësore, nga të cilat 23 janë akoma në proces gjykimi nga gjykatat e rretheve ose nga ato të apelit, ndërsa 4 janë çështje të përfunduara (1 është mbyllur në favor të KKRT-së, për 3 çështje është vendosur pushimi i gjykimit).

Në përgjithësi, objekti i këtyre çështjeve gjyqësore konsiston në kundërshtimin e akteve administrative, vendimeve të KKRT-së si psh. për mosrinovim licence, pavlefshmëri licence, anullim gjobe, etj.

Megjithatë, nëse do të analizonim ekzistencën e kaq shumë proceseve gjyqësore duhet ta shohim nga dy këndvështrime të ndryshme. Së pari, nëse vendimet e

KKRT-së janë të bazuara ligjërisht dhe së dyti, pasojat e kohëzgjatjes së këtyre proceseve.

Lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të KKRT-së, ligjërisht janë gjykatat ato që e përcaktojnë këtë rast pas rasti (duke pranuar këtu edhe faktorë subjektivë që mund të ndikojnë në marrjen e një vendimi). Gjatë këtij viti, shumica e gjykimeve janë ende në proçes dhe nuk mund të nxirret një përfundim nga bilanci i çështjeve të humbura apo të fituara.

Ndërsa përsa i përket pasojave që sjell zgjatja 2-3 vjeçare e gjykitit të çështjeve ato po bëhen gjithmonë e më shumë problematike për KKRT-në. E drejta e operatorëve për t'i kundërshtuar vendimet e KKRT-së në gjykatë është në parim një e drejtë e pamohueshme, por zvarritja e proceseve bën që operatorët, në rastet e heqjes apo mosrinovimit të licencave, edhe kur ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së nuk është pezulluar nga gjykata, të vazhdojnë aktivitetin e tyre duke mos njojur më autoritetin e KKRT-së. Me justifikimin që janë në një proçes gjyqësor ata nuk respektojnë më kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, transmetojnë programe të piratuara duke shkelur të drejtat e transmetimit dhe të gjitha rregullat e konkurrencës së ndershme. Në disa raste, as Policia Tatimore nuk ka vënë në zbatim ekzekutimin e urdhreve të KKRT-së për blokimin e aktivitetit të operatorëve që kanë mbetur pa licencë, pikërisht prej vazhdimësisë së gjykimeve. Ky është një problem, që shpresojmë të gjejë zgjidhje në ligjin e ri që po hartohet.

Një pasqyrim në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore që aktualisht janë në gjykim vijon si më poshtë:

- **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

**TV Arbëria – KKRT** me objekt – anullimi i vendimit nr. 532, datë 20.11.2006 të KKRT-së, për ndëshkimin me sanksionin e paralajmërimi.

**Media + sh.a (TV Shijak) – KKRT** me objekt – detyrim për shpërblim dëmi në shumën 143.603.288 lekë.

**Halil Lalaj – KKRT** me objekt – kërkohet kundërshtimi i Urdhrit administrativ nr. 66, datë 22.06.2007 të Kryetarit të KKRT-së, akt i nxjerrë në zbatim të vendimit nr. 593, datë 04.06.2007 të KKRT-së; kërkohet pezullimi i ekzekutimit të këtij urdhri.

**Radio Koha – KKRT** me objekt – shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 537, datë 20.11.2006 të KKRT-së, "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinnovimin e licencës dhe miratimin e masës së gjobës të vendosur ndaj subjektit "Radio Koha", pezullimin e menjëhershëm të aktit administrativ.

**Radio Koha – KKRT** me objekt – shfuqizimin e vendimit të KKRT-së, për shpalljen e njofitimit publik për hapjen e garës për radio locale në frekuencën 98.1 MHZ, pronë e Radio Koha; pezullimin e menjëhershëm të aktit administrativ.

**Media Vizion sh.a. (Vizion +) – KKRT** me objekt – pavlefshmëria absolute e Vendimit nr. 631, datë 08.10.2007 të KKRT-së, heqja e masës së sekuestros dhe kthim të sendeve, pajisjeve të bllokuara nëpërmjet këtij vendimi; marrja e masës së sigurimit të padisë, për pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

- **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër**

**Radiotelevizioni Kabllor Memaliaj – KKRT** me objekt – anullimi i gjobës nr. 0169, datë 19.04.2007 dhe vendimit nr. 589, datë 04.06.2007 të KKRT-së, (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0169, datë 19.04.2007 në masën 2.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së për pirateri). Gjykata, me vendimin e saj nr. 1359/T-440, datë 11.12.2007 vendosi rrëzimin e padisë së radiotelevizonit kabllor Memaliaj, duke lënë në fuqi vendimin nr. 589, datë 04.06.2007 të KKRT-së.

**Radiotelevizioni Kabllor Memaliaj – KKRT** me objekt – Pezullimi dhe shfuqizimi i urdhrit nr. 91, të datës 07.09.2007 nxjerrë për zbatimin e vendimit nr. 589, datë 04.06.2007 të KKRT-së, si dhe vendosjen në afat të ankimit ndaj tij. (Lidhur me gjobën nr. 0169, datë 19.04.2007 në masën 2.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së për pirateri). Gjykata, me vendimin nr.1438/T-453 vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile, për mosparaqitje të paditësit.

- **Në Gjykatën e Apelit Tiranë**

**TV BBF – KKRT** me objekt – shfuqizimin e vendimit nr. 549, datë 28.12.2006 të KKRT-së ; pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 2374, datë 03.04.2007, vendosi pranimin e padisë së Shoqërisë "BBF" sh.a, duke anulluar vendimet nr. 536, date 20.11.2006 dhe nr. 549, date 28.12.2006 të KKRT-së si të pavlefshëm dhe detyrimin e të paditurit për të rinovuar licencën e paditësit, si dhe pezullimin e pasojave të këtyre akteve administrative të sipërcituara derisa ky vendim gjyqësor të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 17.04.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**TV Arbëria – KKRT** me objekt – kundërshtimi i vendimit nr. 0161, datë 08.01.2007 të Grupit të inspektimit të KKRT-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 2549, datë 10.04.2007, vendosi të rrëzojë padinë e palës paditëse "Televizioni Arbëria sh.a." si të pambështetur në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse u depozitura kërkesa-ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Radio Stinët – KKRT** me objekt – anullimin e aktit administrativ nr. 416, datë 28.02.2006 të KKRT-së si akt i pavlefshëm (Lidhur me heqjen e licencës së radio Stinët). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 2635, datë 12.04.2007, vendosi rrëzimin e padisë së Shoqërisë "Stinët" sh.p.k., duke lënë në fuqi vendimin nr. 416, datë 28.02.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Nertila Kellici – KKRT** me objekt – Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë me pagën e një viti për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës; - Të më paguajë me 2 muaj pagë për moszbatim të afateve të njoftimit; - Të më paguajë me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; - Pagimin e 3 ditëve pune të papaguara, pagimin e shpërblimit në mënyrë përpjesëtimore të kohës së punës për vitin 2006, si dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 3845, datë 22.05.2007, vendosi pranimin pjesërisht të kérkesë-padisë; - Detyrimin e të paditurit KKRT-ja të dëmshpërblejë paditësen Nertila Kelliçi në masën e pagës së 8 (tetë) muajve punë, për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës; - Detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditëses pagën e 2 (dy) muajve, për mosrespektimin e afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës; - Detyrimin e te paditurit për të dëmshpërblyer paditësen në masën e pagës së 2 (dy) muajve, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; - Detyrimin e të paditurit të paguajë shpenzimet gjyqësore në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata; - Rrezimin e kérkesë-padisë në pjesët e tjera të saj si të pabazuar në prova e në ligj. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 06.06.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 515, datë 09.10.2006 të KKRT-së (Lidhur me reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës nr. 022/RTV Kabllor "AVN" në masën 50% të afatit të saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj datë 13.12.2006, vendosi të pranojë kérkesën e KKRT-së për kalimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mbështetje të nenit 42 dhe 327 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën lëndore. Pala paditëse ka ushtruar ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë në datën 15.02.2007 pasi shqyrtoi kérkesën e palës paditëse vendosi që kjo çështje të gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo çështje filloj të gjykohet në datën 24.04.2007 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas 3 seancave gjyqësore në datën 26.06.2007 paditësi kërkoi pezullimin e gjykit të çështjes, me arsyetimin se meqenëse janë 3 procese civile duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kanë lidhje me këtë çështje. Gjykata e pranoi kérkesën e paditësit dhe vendosi pezullimin e gjykit të çështjes civile me nr. 5247. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 02.07.2007 është depozituar kérkesa-ankimore brenda afateve ligjore për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë në datën 13.12.2007 vendosi të

Ierë në fuqi pezullimin e gjykimit të çështjes civile me nr. 5247, duke mos e marrë në konsideratë ankimin tonë.

**TV Real – KKRT** me objekt – konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit nr. 515/1, datë 09.10.2006 të KKRT-së; detyrimi i KKRT-së që të rinovojë licencën e TV Real; marrja e masës së sigurimit për mos-ndërprerjen e transmetimit deri në përfundim të gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5441, datë 10.07.2007 vendosi pranimin pjesërisht të padisë së Shoqërisë "Real TV", duke annulluar vendimin nr. 515/1, datë 09.10.2006 të KKRT-së dhe duke vodosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit për ndërprerjen e transmetimit nga ky subjekt, deri në përfundimin e këtij gjykimi. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**"Albautor" – KKRT** me objekt – shpërbirim për çdo licencë të dhënë operatorëve radiotelevizivë, pa autorizimin e Albautor (d.m.th. që KKRT ta shpërblyejë për çdo licencë të dhënë operatorëve radiotelevizivë në shumën 50.000 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5586, datë 13.07.2007 vendosi të rrëzojë padinë e palës paditëse "Albautor" si të pambështetur në ligj dhe në prova. Nga ana e palës paditëse u depozitura kërkesa-ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**TNSH – KKRT** me objekt – anullimin e aktit administrativ, Vendimet nr. 529, datë 13.11.2006 të KKRT-së mbi pavlefshmërisë e licencës së subjektit TNSH, marrja e masës për sigurimin e padisë duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 529, datë 13.11.2006 të KKRT-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5355, datë 27.09.2007 vendosi pranimin e padisë së Shoqërisë "Telenorba Shqiptare" sh.a, duke annulluar vendimin nr. 529, date 13.11.2006, si dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij akti derisa ky vendim gjyqësor të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 10.10.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**TV Arbëria – KKRT** me objekt – anullimin e vendimit nr. 567, datë 21.02.2007 të KKRT-së për reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 6441, datë 01.10.2007 vendosi pranimin e kërkesë - padisë së Shoqërisë "Televizioni Arbëria" sh.a, duke annulluar vendimin nr. 567, datë 21.02.2007 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Sefedin Çela – Kuvendi i Shqipërisë; KKRT** me objekt – kërkohet dëmshpërbimi, për shkak të ndërprerjes së mandatit të anëtarit të KKRT-së pa shkaqe të arsyeshme; dhënia e këtij vendimi me ekzekutim të përkohshëm. KKRT është thirrur në këtë çështje si person i tretë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj 7697, datë 07.11.2007 vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë së Z. Sefedin Çela, duke vodosur detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë t'i paguajë paditësit Sefedin Çela

pagën e 3 (tre) viteve punë në masën 1.620.000 (një milion e gjashtëqind e njëzetë mijë) lekë. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**TV A1 (Ballkan) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 508, datë 29.09.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0123, datë 09.05.2006 në masën 2.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së për dalje në transmetim pa autorizim në sistemin numerik). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7581, datë 05.11.2007 vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

- **Në Gjykatën e Apelit Vlorë**

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0098, datë 03.11.2004 në masën 800.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1503, datë 14.11.2005 kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkesë-padisë, anullimin e gjobës datë 03.11.2004 të grüpuit të inspektimit të KKRT-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj të datës 30.05.2006 vendosi të kthejë për rigjykim dosjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në rigjykim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 217, datë 07.02.2007 kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkesë-padisë, anullimin e gjobës datë 03.11.2004 të grüpuit të inspektimit të KKRT-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së. Kundër vendimit nr. 217, datë 07.02.2007 nga ana e KKRT-së në datën 23.02.2007 është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë në datën 02.11.2007 mori në shqyrtim ankimin tone. Pas 3 seancave të gjykit të kësaj çështje gjykatë vendosi të pranojë kërkesën tonë për përashtim gjyqtari. Jemi në pritje të caktimit të datës tjeter të seancës gjyqësore me një tjetër trup gjyques, sepse dosja do të hidhet në short.

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 513, datë 09.10.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0136, datë 25.09.2006 në masën 500.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1051, datë 02.07.2007 vendosi rrëzimin e padisë së TV AVN, duke lënë në fuqi vendimin nr. 513, datë 09.10.2006 të KKRT-së. Nga ana e palës paditëse u depozitura kërkesa-ankimore për në Gjykatën e Apelit Vlorë.

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 527, datë 13.11.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0140, datë 02.10.2006 në masën 1.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1070, datë 04.07.2007 vendosi pranimin e padisë së TV AVN, duke anulluar vendimin nr. 527, datë 13.11.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 20.07.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 514, datë 09.10.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0137, datë 28.09.2006 në masën 800.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1101, datë 10.07.2007 vendosi pranimin e padisë së TV AVN, duke anulluar vendimin nr. 514, datë 09.10.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 04.09.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

- **Çështje gjyqësore të përfunduara**

**TV A1 (Ballkan) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 505, datë 05.09.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0130, datë 19.06.2006 në masën 200.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5357, datë 06.07.2007 vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile. Nga ana e palës paditëse nuk u paraqit asnjë kërkesë ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në këto kushte, ky vendim ka marrë formë të prerë.

**TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 321, datë 07.03.2005 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0106, datë 02.02.2005 në masën 300.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 648, datë 16.05.2005 kjo gjykate vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit Fatos Mihali, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e TV AVN është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj nr. 101, datë 28.02.2006 la në fuqi vendimin nr. 648, date 16.05.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në datën 27.03.2006 TV AVN ka depozituar rekurs për në Gjykatën e Lartë. Në datën 27.04.2007 është vendosur mospranimi i rekursit. Vendimin nr. 648, datë 16.05.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka marrë formë të prerë.

**Media Vizion sh.a. (Vizion +) – KKRT** me objekt – pushimin e cënimit të pronësisë dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen; shpërblim për shkaktimin e dëmit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 14.12.2007 me vendimin nr. 9119 vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile, për mosparaqitje të paditësit. Nga ana e palës paditëse nuk u paraqit asnjë kërkesë ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në këto kushte, ky vendim ka marrë formë të prerë.

**Z. Laidan Dani (TV Info Shkodra) – KKRT** me objekt – anullimin e Vendimit nr. 597, datë 01.10. 2007 "Për mosdhënie licence" i KKRT, Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 03.12.2007 vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile, për mosparaqitje të paditësit. Nga ana e palës paditëse nuk u paraqit asnjë kërkesë ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në këto kushte, ky vendim ka marrë formë të prerë.

## 2.6 Prokurimet e zhvilluara nga KKRT

Lidhur me prokurimet e zhvilluara nga KKRT për vitin 2007, informojmë se në datën 01.01.2007 ka hyrë në fuqi ligji nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik". Në zbatim të këtij ligji, me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", Këshilli Ministrave ka miratuar rregullat përkatëse nënligjore për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të prokurimit.

Gjithashtu, në zbatim të akteve të sipërcituara, APP ka nxjerrë udhëzimet dhe sqarimet përkatëse me qëllim zbatimin sa më të mirë dhe të qartë të procedurave të prokurimit. Kësosoj, për prokurimet e zhvilluara nga KKRT për vitin 2007 janë zbatuar aktet e reja ligjore dhe nënligjore të sipërcituara.

Ndër të tjera, bazuar në aktet ligjore në fuqi për prokurimet publike, jo vetëm dokumentacioni plotë i tenderit por dhe çdo fazë e procedurës së prokurimit (procesverbali hapjes dhe shqyrtimit dhe ofertave, njoftimi kontratës së nënshkruar) përcillen dhe depozitohen në APP. Tani, dokumentacioni i plotë i tenderit u vihet falas në dispozicion firmave të interesuara për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, pasi ky dokumentacion shpallet publikisht në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në këtë mënyrë, në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e një procedure prokurimi kanë të drejtë të paraqesin ofertat përkatëse konform rregullave ligjore në fuqi, si firmat që i kanë tërhequr dokumentet e tenderit falas në rrugë elektronike ashtu dhe ato të cilat i kanë tërhequr dokumentet e tenderit kundrejt pagesës duke u paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Konkrektisht, për vitin 2007 janë realizuar prokurimet me objekt:

- "Blerje pajisje kompjuterike".

Në bazë të Urdhrit të Prokurimit nr. 14, dt. 28.02.2007, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, u realizua Procedura e Prokurimit Kërkesë për Propozim me objekt "Blerje pajisje kompjuterike", për nevojat e administratës së KKRT-së, me fond limit në vlerën prej 1.590.000 (njëmillion e pesëqindenëntëdhjetë mijë) lekë.

Hapja e ofertave u bë më datë 21.03.2007 ora 10.00, firmat që kishin paraqitur oferta ishin "Albania Computers" sh.p.k, "Infosoft System" sh.a. dhe "BNT Electronics" sh.p.k. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në vend të parë u shpall firma "BNT Electronics" sh.p.k. me ofertë 1.334.000 Lekë, si oferta me çmimin më të ulët.

Vendimi i Komisionit të Prokurimit për klasifikimin përfundimtar i'u njoftua firmave pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Pas marrjes së këtij njoftimi Firmat pjesëmarrëse nuk patën asnjë ankesë në lidhje me këtë vendim. Pas publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e APP-së, me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

- "Blerje karburanti".

Në bazë të Urdhrit të Prokurimit nr. 13, dt. 28.02.2007, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, u realizua Procedura e Prokurimit Kërkesë për Propozim me objekt "Blerje karburanti", për nevojat e administratës së K.K.R.T-së, me fond limit në vlerën 1.600.000 (njëmillion e gjashtëqindmijë) lekë.

Hapja e ofertave u bë më datë 20.03.2007 ora 10.00, firmat që kishin paraqitur oferta ishin "Skënderi G" sh.p.k. dhe "Rajca" sh.p.k. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në vend të parë u shpall firma "Skënderi G" sh.p.k. me ofertë 1.581.667 Lekë, si oferta me çmimin më të ulët.

Vendimi i Komisionit të Prokurimit për klasifikimin përfundimtar i'u njoftua firmave pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Pas marrjes së këtij njoftimi Firmat pjesëmarrëse nuk patën asnjë ankesë në lidhje me këtë vendim. Pas publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e APP-së, me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

- "Blerjen e organeve të shtypit nëpërmjet abonimit vjetor".

Në bazë të Urdhrit të Prokurimit nr. 16, dt. 02.03.2007, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, u realizua Procedura e Prokurimit Kërkesë për Propozim me objekt "Blerjen e organeve të shtypit nëpërmjet abonimit vjetor", për nevojat e administratës së KKRT-së, me fond limit në vlerën 700.000 (shtatëqindmijë) lekë.

Hapja e ofertave u bë më datë 27.03.2007 ora 10.00, firmat që kishin paraqitur oferta ishin "Shërbimi Botimeve dhe Shtypit", "Agjencia e Abonimeve te Shtypit" dhe "Posta Shqiptare". Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në vend të parë u shpall firma "Agjencia e Abonimeve të Shtypit" me ofertë 485.810 Lekë, si oferta me çmimin më të ulët.

Vendimi i Komisionit te Prokurimit për klasifikimin përfundimtar i`u njoftua firmave pjesëmarrëse ne procedurën e prokurimit. Pas marrjes së këtij njoftimi Firmat pjesëmarrëse nuk patën asnjë ankesë në lidhje me këtë vendim. Pas publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e APP-së, me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

- "Blerje kancelarie dhe bojra printeri dhe fotokopjeje".

Në bazë të Urdhrit të Prokurimit nr. 15, dt. 02.03.2007, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, u realizua Procedura e Prokurimit Kërkesë për Propozim me objekt Loti I "Blerje kancelarie" dhe Loti II "Blerje bojra printeri dhe fotokopjeje", për nevojat e administratës së KKRT-së, me fond limit Loti 1- 490.000 (katërqindenëtëdhjetëmijë) Lekë dhe Loti 2- 661.560 (gjashtëqindëgjashtëdhjetënjëmijë e pesëqindëgjashtëdhjetë) Lekë.

Hapja e ofertave u bë më datë 26.03.2007 ora 10.00, firmat që kishin paraqitur oferta ishin "Infosoft Office" dhe "Ermira Lulaj". Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në vend të parë u shpall firma "Infosoft Office" me ofertë Loti I 237.458 Lekë dhe Loti II me ofertë 456.583 Lekë, si oferta me çmimin më të ulët.

Vendimi i Komisionit të Prokurimit për klasifikimin përfundimtar i`u njoftua firmave pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Pas marrjes së këtij njoftimi Firmat pjesëmarrëse nuk patën asnjë ankesë në lidhje me këtë vendim. Pas publikimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e APP-së, me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

- "Blerje 2 automjete".

Në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 74 dt. 03.07.2007 me objekt "Blerje 2 autovetura tip fuoristradë", Urdhrit nr. 85 datë 08.08.2007 për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe Urdhrit nr. 86 datë 09.08.2007 për shtyrjen e afatit të zhvillimit të tenderit, Komisioni i Prokurimit u mblohd më datë 24.08.2007 ora 10.00 për të zhvilluar hapjen dhe shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me objekt "Blerje 2 autovetura tip fuoristradë", me fond limit 5.200.000 (pesëmillion e dyqindmijë) lekë.

Në vendin dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e tenderit u paraqit vetëm një operator ekonomik, e për rrjedhojë, për shkak të mungesës së konkurrencës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mbyllë mbledhjen e tij, pra të ndërpresë procedurën dhe ti propozojë titullarit të autoritetit kontraktor përsëritjen nga e para të procedurave të prokurimit. Për sa më sipër, mbështetur në Rregullat e Prokurimit Publik Kreu VII "Kushte të Përgjithshme për Zbatim" pika a "Mungesa e Konkurrencës", doli Urdhri nr. 88 datë 27.08.2007 për anullimin (ndërprerjen) e procedurave të mëtejshme të prokurimit me objekt "Blerje 2 autovetura tip fuoristradë".

Bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik Kreu VII "Kushte të Përgjithshme për Zbatim" pika b dhe Urdhrit nr. 109 datë 23.10.2007 të Kryetarit të KKRT-së u përgatitën specifikimet e reja teknike për tenderin me objekt "Blerje 2 automjete (1 Autoveturë Tip Fuoristradë dhe një Autoveturë Tip Berlina)". Specifikimet e reja teknike erdhën si një rishikim i specifikimeve teknike nr. 72/3 prot., datë 03.07.2007. Gjithashtu, mbështetur në relacionin e Drejtorisë Ekonomike, fondi limit ndryshoi duke u shtuar tanimë në vlerën 5.416.000 lekë nga 5.200.000 lekë që ishte herën e parë.

Në bazë të Urdhrit të Prokurimit nr. 110, dt. 23.10.2007 nr. 1027 prot., si dhe Urdhrit nr. 110/1 dt. 30.10.2007 nr. 1027/4 prot., të Kryetarit të KKRT.-së dhe në zbatim të akteve ligjore ne fuqi, u realizua Procedura e Prokurimit, Procedurë e Hapur me objekt "Blerje 2 automjete", Loti I "Blerje automjet tip fuoristradë" dhe Loti II "Blerje automjet tip berlina" për nevojat e administratës së K.K.R.T-së, me fond limit 5.416.000 lekë.

Hapja e ofertave u bë më datë 10.12.2007 ora 10.00, firmat që kishin paraqitur oferta ishin "Auto Union" sh.p.k dhe "Classic" sh.p.k. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në vend të parë u shpall firma "Auto Union" sh.p.k. me ofertë Loti I 3.000.000 Lekë dhe Loti II 2.300.000 Lekë, si oferta me çmimin më të ulët.

Vendimi i Komisionit të Prokurimit për klasifikimin përfundimtar i'u njoftua firmave pjesëmarrëse në proceduren e prokurimit. Pas marrjes së këtij njoftimi Firmat pjesëmarrëse nuk patën asnjë ankesë në lidhje me këtë vendim. Pas botimit të njoftimit të fituesit në Buletinin e radhës së APP-së, me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

### **3 PROGRAMACIONI**

#### **3.1 Situata programore në media**

Gjatë vitit 2007, KKRT ka pasur në qendër të vëmendjes respektimin e parimeve themelore të ushtrimit e të zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive në fushën programore. Në stadin e tanishëm të kësaj veprimtarie nuk shtrohet më çështja e njohjes dhe e zbatimit formal të këtyre parimeve, por sendërtimi i tyre në të gjithë përmbajtjen e programacionit të medias sonë elektronike, duke synuar një cilësi gjithnjë e më të lartë.

Këtij qëllimi i ka shërbyer hartimi i një strategjie të re në njohjen e vlerësimin e politikave programore të operatorëve radiotelevizivë, sidomos atyre kombëtarë, strukturimi i ri i departamentit të programeve në KKRT, ngritura dhe bashkëpunimi i sektorëve të ndryshëm që konvergojnë në monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me operatorët radiotelevizivë si dhe sensibilizimi i opinionit publik. Në themel të këtij komunikimi qëndron zbatimi i legjislacionit në fuqi, njohja dhe evidentimi i dukurive të reja në fushën e programacionit, plotësimi i hapësirave ligjore dhe ndërgjegjësimi i operatorëve për domosdoshmérinë e shumëllojshmërisë së programeve dhe rritjen e cilësisë së tyre.

Në strategjinë e re të KKRT-së në fushën e programacionit, për vitin 2007, më shumë sesa komunikimi shkresor, paralajmërimet e sanksionet që parashikon ligji për rastet e shkeljeve të ndryshme, ka zënë vend marrja e masave dhe hartimi e zbatimi i praktikave që ndihmojnë operatorët radiotelevizivë të jenë vetë ata të interesuar për respektimin e parimeve themelore të komunikimit audiovizual, të konkurrencës së ndershme, të transparencës në financimin e programeve, respektimin e etikës televizive e standardeve gjuhësore etj.

Këtij qëllimi i kanë shërbyer njohja dhe publikimi i përvojës evropiane në këtë fushë, ngritura e funksionimi i Këshillit të Etikës pranë KKRT-së, hartimi i rregulloreve të ndryshme, transparenca e vendimeve të KKRT-së dhe marrëdhëniet e drejtpërdrejta me operatorët radiotelevizivë, institucionalizimi i komunikimeve me shtypin e shkruar etj.

Duke e përjashtuar censurën dhe cënimin e pavarësisë editoriale, KKRT, përmes mjeteve që i lejon ligji, është përpjekur të ndikojë pozitivisht në ruajtjen e raportit delikat midis të drejtës për informim dhe privatësisë së individit.

Nga monitorimi i edicioneve informative të disa operatorëve televizivë rezulton se ka raste kur nuk zbatohen kërkesat e ligjit 8410, dt. 30. 09. 1998, i ndryshuar, nen 36 dhe nen 38, që sanksionojnë respektimin e dinjitetit vetjak, të drejtave

themelore të njeriut dhe ndalimin e informacioneve që cënojnë jetën private të shtetasve.

Krahas regjistrimeve nga vetë operatorët, janë përdorur jo rrallë edhe regjistrimet, ose filmimet e komisariateve të policisë për persona që ende janë të dyshuar, faji i të cilëve nuk është vërtetuar në gjykatë. KKRT është angazhuar që, pa dëmtuar transparencën në mbrojtje të ligjit e të rendit publik, këta individë të jenë objekt i kronikave të medias vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në mjedisin programor të medias elektronike vihet re kontradikta midis domosdoshmërisë së programeve televizive formuese edukative dhe nevojës për programe komerciale, midis përbajtjes cilësore të programeve, respektimit të kodeve morale dhe etike, jo gjithnjë të shprehura në ligj, dhe nëpërkëmbjes së tyre, që cënojnë drejtpërdrejt, ose tërthorazi dinjitetin e shikuesve.

Në rastet kur janë cënuar këto raporte, KKRT ka ndërhyrë pranë operatorëve radiotelevizivë duke zbatuar masat që parashikon ligji dhe respektimi i Kodit të Etikës. Kryesisht në zhantin e varieteve televizive humoristike janë vërejtur tendenca për t'i ofruar publikut skeçe, situata, tekste dhe interpretime të shoqëruara me deformimin e gjuhës, përcjelljen e mesazheve vulgare, keqpërdorimin e temës seksuale pa respektuar normat etike dhe morale.

Edhe pse dinamika e formave të ndryshme programore ka ritme të ndryshme në operatorë të veçantë, në fasha orare të caktuara dhe në raporte kohore që gjithashtu ndryshojnë nga një televizion në tjeterin, hasen me vështirësi dukuri të reja në fushën e programacionit. Edhe kur ka të tilla, ato organizohen në struktura programore të njoitura, shpesh rutinë që shfaqen me ndryshime të vogla, nga një operator në tjeterin.

Gjatë vitit të kaluar është vënë re konsolidimi i programeve që kanë pasur një audiencë relativisht të lartë si debatet politike, edicionet informative, varietetë televizive humoristike dhe, sidomos, programet muzikore që kanë në thelb elementin konkurrues.

Për sa më sipër, në programet e aktualitetit do të përmendnim "Opinion" në TV "Klan", "Bardh e zi" në TVA, "Top Show" dhe "Shqip" në Top Channel, "Logos" dhe "Zip" në "Vizioni+", "Sfida & strategji" dhe "7x7" në TVSH, "60 minuta" në TV "Koha", por edhe edicionet informative të televizioneve të lartpërmendura, duke shtuar edhe operatorët televizivë, që janë të licensuar posaçërisht për të transmetuar programe informative si "News 24", "Ora", "Nesër TV" e ndonjë tjeter, të cilët kanë ndikuar në informimin e publikut dhe formimin e opinioneve dhe krijimin e standardeve editoriale me kritere profesionale bashkëkohore.

Është për t'u theksuar fakti që, në operatorin publik, u transmetuan debate politike, që një vit më parë ishin pronë e televizioneve private komerciale. Kjo dukuri u vu re edhe gjatë fushatës për zgjedhjet vendore 2007.

Audienca e lartë vihet re në programet televizive si "Portokalli", "Top Fest", "Fiks Fare" dhe "Top Show", "Zip" dhe "Njerëz të humbur", "Skaner" dhe "Kthehem të dielën", "Këngët e Shekullit" dhe "Akademia e yjeve", "Kontekst" dhe "Vonë në TVA", "Impuls rinor" dhe "Hitlist Albania", "Post Scriptum", apo "Media Forum" etj.

Po ashtu, në programacionin e operatorëve televizivë, ka zënë një vend gjithnjë e më të madh transmetimi i programeve të huaja të blera, filmave, dokumentarëve dhe sidomos i programeve sportive e telenovelave. Në këtë fushë tashmë zbatohen, thuajse plotësisht, kërkesat e ligjit për respektimin e kontratave si dhe raporti gjuhë e huaj – subtitrim, ose dublim në gjuhën shqipe. Tashmë është tejkaluar fenomeni i transmetimit të ekranizimeve të ndryshme pa përkthim e titrim, apo pa dublim në gjuhën shqipe, pavarësisht nga cilësia e përkthimit apo përdorimit të normës letrare të gjuhës shqipe.

Me përjashtime të vogla, te të gjithë operatorët televizivë vihen re shkelje të standardeve gjuhësore që kanë për pasojë deformimin dhe dëmtimin e gjuhës amtare. KKRT ka tërhequr vëmendjen për këtë problem të rëndësishëm dhe synon që në të ardhmen ta ketë një nga synimet parësore të veprimtarisë së vet. Këto shkelje të normës gjuhësore për drejtshkrimin e drejtshqiptimin e gjuhës shqipe janë më të dukshme në edicionet informative dhe në përkthimin, dublimin, ose subtitrimin e filmave dhe telenovelave si dhe në programe të tjera të llojeve të ndryshme, veçanërisht në emisionet përfmijë e të rinj.

Përveç shkeljeve të mësipërme konstatohet një përdorim i shumtë e i panevojshëm i fjalëve të huaja, ndërtimë sintaksore e gramatikore që prekin strukturën thelbësore të gjuhës shqipe, duke e shtrembëruar dhe deformuar natyrën dhe misionin e saj e duke vështirësuar komunikimin me shikuesit.

Nga ana tjetër nuk ka qenë jashtë vëmendjes së KKRT-së fakti se, në disa operatorë televizivë, ku përfshihen edhe ato numerikë, janë shfaqur, në mënyrë integrale, prodhime kinematografike që glorifikojnë diktaturën komuniste e udhëheqësit e saj. Për këtë gjë KKRT ka rekomanduar jo ndalimin, por transmetimin kritik të filmografisë të kohës së diktaturës, të shoqëruar me analiza e komentet përkatëse, në fasha orare të përshtatshme. Media elektronike duhet të bëhet pjesë e dënimit të diktaturës, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj filmografisë që e glorifikon atë, duke kërkuar mjete e mënyra transmetimi që nuk dëmtojnë formimin dhe edukimin e fëmijëve e moshave të reja.

Nga rreziku i rendjes drejt programeve komerciale nuk kanë shpëtuar as televizonet kombëtare. Pasojë e kësaj tendencë është varfëria dhe mungesa e përmbajtjes dhe sidomos e cilësisë në programet përfmijë e të rinj. Këto programe nuk janë ngritur as në nivelin e teleshikuesve të cilëve u drejtohen, e në mjaft raste nuk respektojnë të drejtat e të miturve dhe adoleshentëve, nuk kanë strukturë e përmbajtje të konsoliduar, keqpërdorin gjuhën, shijet e veçoritë e moshës, duke ndikuar jo pak në edukimin e formimin e tyre.

KKRT vëren se shkalla e fuqizimit të disa mediave elektronike është e tillë, saqë nuk mund ta nënveftësojë më dhe ta lërë pas dore një fushë kaq të rëndësishme të programacionit si emisionet përfëmijë e të rinj. Tashmë kjo gjë është jo vetëm domosdoshmëri e plotësimit sasior e cilësor të strukturës programore, për të cilën operatorët radiotelevizivë janë licencuar, por edhe detyrim qytetar e kombëtar, problem me të cilin KKRT do të merret seriozisht në të ardhmen.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për emisionet e mirëfillta kulturore (libri, teatri, filmi, pikturna) apo arsimore, shëndetësore e edukative (shkolla dhe problemet e saj), të cilat janë thuajse të përjashtuara nga programacioni i shumicës së operatorëve radiotelevizivë.

### *3.2 Programet informative*

Edhe gjatë vitit 2007 operatorët radiotelevizivë kanë pasur si pikësynim që programet informative të janë pjesa më e rëndësishme e strukturës programore. Duhet theksuar fakti se po ndihet një përmirësim jo i vogël i pavarësisë editoriale në krahasim me një vit më parë, megjithëse ende zbatohet një qëndrim editorial që është në favor të interesave të pronarëve të radiove dhe televizioneve private. Mungojnë kronika apo programe të posaçme të gazetarisë investigative, apo më saktë ato janë pronë e shumë pak operatorëve, tashmë me audiencë të siguruar.

Edicionet informative të operatorëve kryesorë privatë kombëtarë dhe vendorë si "Klan", "Top Channel", "TVA", "Vizion +", "Koha", "Neës 24", "Alsat", "Nesër TV", Top Albania Radio, Radio "Club FM", Radio "Alfa dhe Omega", radio "Euro Star", radio "Sport" janë nga më të ndjekurat në zonat e tyre të licensimit.

Nga operatorët radiotelevizivë lokalë nëpër rrethe do të veçnim telezionale si, "Kombi" dhe "Apollon" në Fier, TV "4+" në qytetin e Lushnjës, "Alpo" dhe "Channel 7"- Gjirokastër, "Amantia" – Vlorë, "Magic Star" në Korçë, TV "2 A" në Kavajë, TV "Rozafa" në Shkodër, TV "Kukësi", TV "Egnatia" në Elbasan, "Lobi" dhe ARV në Pogradec, "Tele JONI" në Sarandë, radio "Star" në Fier, radio "Saranda", radio "Valë e Kaltër" në Vlorë, radio "Alfa" në Elbasan etj, etj.

Radiot dhe televizonet vendore vazhdojnë të informojnë dëgjuesit dhe shikuesit si nëpërmjet edicioneve të lajmeve, ashtu edhe me programe kulturore, edukative. Duke përjashtuar operatorët tematikë, radiot edhe televizonet vendore janë të detyruara sipas ligjit, që të paktën 15% e programeve javore të përbajnjë informacion dhe programe që lidhen me realitetin lokal, detyrim që në përgjithësi realizohet nga operatorët televizivë, por anashkalohet nga ata radiofonikë.

Krahas edicioneve të lajmeve, programet e tjera informative dhe të aktualitetit të përgatitura dhe transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë, plotësojnë fizionominë e operatorëve profesionalisht të formuar dhe me audiencë të konsiderueshme. Tematika e larmishme, debatet politike dhe sociale për çështje me rëndësi për publikun e gjërë, mënyra e përfshirjes së publikut në debat, janë veçantitë që karakterizojnë programet e aktualitetit si "Shqip", "Opinion", "Top Story", "Logos" si më të ndjekurit në llojin e vet e që konkurrojnë pozitivisht e denjesisht me njëri-tjetrin.

Në mbështetje të ligjit "Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", KKRT është e detyruar të monitorojë të gjitha programet informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë. Në raste të veçanta, KKRT monitoron edhe programet informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë vendorë. Për sa më sipër, parashikohet si rregull, pasqyrimi i fushatave zgjedhore nga operatorët radiotelevizivë. Gjatë vitit 2007, e saktësisht në muajin shtator, KKRT miratoi propozimin për të monitoruar edhe programet informative të televizioneve vendorë "Top Channel" dhe "Vizioni+", duke i konsideruar si operatorë me ndikim të konsiderueshëm në formimin e opinioneve te publiku i gjërë, me audiencë në tregun mediatik dhe konkurrentë potencialë për t'u pajisur me licensë kombëtare, proçes për të cilin KKRT kishte filluar përgatitjen e procedurave për shpalljen e garës.

Gjatë vitit 2007, nga Departamenti i Programave në KKRT, u monitoruan edicionet kryesore të lajmeve të Radiotelevizonit Shqiptar, televizioneve kombëtare "KLAN" e "ARBËRIA". Në periudhën Mars-Qershori 2007 u monitoruan edicionet e lajmeve kryesore të radiove kombëtare "Top Albania Radio" e "Radio +2". Gjithashtu, në periudhën Shtator-Nëntor 2007 u krye edhe monitorimi i edacioneve informative të televizioneve "Top Channel" dhe "Vizioni+".

Përveç praktikës së publikimit në faqen e internetit, rezultatet e monitorimit u janë bërë të njoitura të gjithë operatorëve radio dhe televizivë të monitoruar, për periudhat respektive. Këto rezultate u janë paraqitur edhe Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë, partive politike parlamentare si dhe institucioneve ndërkombëtare të specializuara, të cilat vëzhojnë median shqiptare.

Raportet e monitorimit paraqesin kryesisht të dhëna kuantitative, prej të cilave mund të nxirren lehtësisht edhe qëndrimet e operatorëve radiotelevizivë të monitoruar ndaj kaheve të politikës, pra pozitës dhe opozitës. Aty përfshihen të dhëna statistikore mbi kohën e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizivë në edicionet kryesore të lajmeve, për veprimtaritë e partive politike, për veprimtarinë e organeve të qeverisë dhe parlamentit, të aktorëve të ndryshëm të politikës dhe organeve të pushtetit. Në raportet mujore të monitorimit jepen të dhëna mbi paraqitjen "sinkron" të personaliteteve politike dhe shtetërore në radio dhe televizion.

**Radiotelevizioni Shqiptar:** Në vitin 2007 rreth 57% (55% në vitin 2006) e kohës në edicionet kryesore të lajmeve në TVSH, i është kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të pozitës, pra qeverisë, kryeministrit dhe partive parlamentare të mazhorancës. (Këtu përfshihet koha për pasqyrimin e veprimtarive të PD, PR, PAA, PBLD, PDR, PDK). Rreth 26% (30% në vitin 2006) e kësaj kohe i është vënë në dispozicion pasqyrimit të veprimtarive të opozitës. Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur qeveria me 27.82% (24% në vitin 2006) dhe kryeministri me 18.53% (20.7% në 2006). Veprimtaritë e Parlamentit kanë gjetur pasqyrim në rreth 10.5% të kohës së përgjithshme të edacioneve informative, po aq sa edhe një vit më parë.

Aktori kryesor me kohën më të madhe sinkron në TVSH, ka qenë kryeministri Sali Berisha me rreth 20% të kohës sinkron në dispozicion të tij për t'iu drejtuar publikut nëpërmjet TVSH-së, po aq sa edhe në vitin 2006. I dyti renditet kryetari i PS-së Edi Rama me rreth 8% (13% në vitin 2006) të kohës sinkron të aplikuar nga TVSH. Qeveria dhe kryeministri janë subjektet që kanë zënë rreth 46% të kohës sinkron në TVSH. Të gjitha partitë e opozitës, së bashku, kanë zënë rreth 30% të kohës sinkron në TVSH, nga të cilat 20% PS dhe 6% LSI.

Tema kryesore e trajtuar nga TVSH në edicionet e lajmeve ka qenë "politika" dhe "problemet sociale" pothuajse me kohë të barabartë (rreth 21%). Lajmet me karakter kulturor dhe artistik, janë të tretat në renditje me 11%. Pothuajse të njëjtën hapësirë ka zënë edhe pasqyrimi i ngjarjeve nga rajoni dhe Kosova, me 9.8% të kohës së përgjithshme të lajmeve.

Të njëjtat raporte ka ruajtur edhe Radio Tirana në edicionet kryesore të lajmeve, ku 51% e kohës i është vënë në dispozicion pasqyrimit të veprimtarive të pozitës dhe 29% pasqyrimit të veprimtarive politike të opozitës. Për institucionet, koha në dispozicion të qeverisë ka qenë 16% dhe për kryeministrin 17%, pothuajse sa një vit më parë.

Aktori kryesor sinkron në Radio Tirana ka qenë kryeministri Sali Berisha, me rreth 25.7% (27.5% në vitin 2006) të kohës sinkron të dhënë për të gjithë aktorët e tjerë politikë. I dyti renditet Edi Rama me 13.3% të kohës së përgjithshme sinkron, sa një vit më parë. Tema kryesore e trajtuar në lajmet e Radio Tiranës ka qenë "politika" dhe "lajmet ndërkombëtare".

**Televizioni kombëtar "KLAN":** Gjatë vitit 2007 rreth 55% (56% në vitin 2006) e kohës televizive i është kushtuar veprimtarive të qeverisë dhe pozitës parlamentare, ndërsa rreth 31% (32% në vitin 2006) e kohës televizive në lajme, i është kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të opozitës. Nga institucionet, qeveria dhe kryeministri kanë zënë respektivisht me 21% dhe 17% të kohës televizive.

Në TV "KLAN" personalitetet politikë që i janë drejtuar publikut sinkron me kohën më të madhe janë Sali Berisha me 20% të kohës së përgjithshme sinkron dhe

Edi Rama me 7% të gjithë kohës sinkron për aktorët politikë. (respektivisht 22% dhe 11% në vitin 2006). Tema kryesore e trajtuar në edicionet e TV Klan ka qenë "politika", "tema sociale" dhe "art /kultura", respektivisht me 16%, 13% dhe 9% të kohës së përgjithshme televizive në lajme.

**Televizioni kombëtar "ARBËRIA":** Edhe gjatë vitit 2007 e ka ruajtur ekuilibrin e një viti më parë në pasqyrimin e veprimtarive të forcave politike, duke përmirësuar edhe mangësitë e paraqitura në formën e përgatitjes dhe paraqitjes së edicioneve informative gjatë vitit 2006.

Rreth 44% (47% në vitin 2006) e kohës në edicionet e lajmeve në TVA, i është kushtuar veprimtarive të partive të pozitës. Rreth 41% e kohës i është dhënë veprimtarive të opozitës, po aq hapësirë sa edhe një vit më parë.

Aktorët politikë, që i janë drejtuar më shumë sinkron publikut në TVA, janë liderët e partive politike kryesore, dhe konkretisht kryeministri Sali Berisha me 12.8% dhe kreu i PS-së Edi Rama me 8.2%.

Tema kryesore e trajtuar nga TVA në edicionet e lajmeve ka qenë "politika" dhe "problemet sociale" pothuajse me kohë të barabartë (rreth 18%). Lajmet ndërkombëtare, janë të tretat në renditje me 14%.

**"Top Albania Radio":** Gjatë vitit 2007 rreth 36% (47% në vitin 2006) e kohës në edicionet e lajmeve i është dhënë pasqyrimi të veprimtarisë së pozitës dhe rreth 40% (37% në vitin 2006) e kësaj kohe i kushtohet pasqyrimi të veprimtarive politike të partive opozitare parlamentare. Aktorët sinkron me kohën më të madhe në dispozicion në TAR, mbeten liderët e partive politike, ku 12.8% të kësaj kohe i jepet kryeministrat dhe Kryetarit të PD-së Sali Berisha dhe 13.5% e kohës sinkron i lihet kryetarit të PS-së Edi Rama.

**"Radio +2":** Gjatë vitit 2007 rreth 30% e kohës në edicionet e lajmeve i është dhënë pasqyrimi të veprimtarisë së pozitës dhe rreth 42% e kësaj kohe, i kushtohet pasqyrimi të veprimtarive politike të partive opozitare parlamentare. Radio +2 nuk aplikon sinkronin në edicionet e lajmeve.

**Televizioni "TOP CHANNEL":** Në periudhën 3 mujore (shtator-nëntor) të monitorimit të edicioneve kryesore të lajmeve në TCH është vërejtur qëndrim i paanshëm dhe pasqyrim i ekuilibruar i veprimtarive politike të pozitës dhe opozitës. Gjatë kësaj periudhe rreth 44% e kohës televizive në edicionet informative, i është kushtuar veprimtarive të qeverisë dhe pozitës parlamentare, ndërsa rreth 43% e kohës televizive në lajme, i është kushtuar pasqyrimi të veprimtarive të opozitës. Nga institucionet, qeveria dhe kryeministri kanë zënë respektivisht me 16% dhe 11% të kohës televizive.

Në TCH personalitetet politikë që i janë drejtuar publikut me kohën më të madhe të kohës së përgjithshme sinkron janë Edi Rama me 12.4% dhe Sali Berisha me 11.9% të gjithë kohës sinkron për aktorët politikë.

Tema kryesore e trajtuar në edicionet e TCH ka qenë "politika" me 23%, "tema sociale" me 17% dhe, në ndryshim nga televizionet e tjera, në vend të tretë renditet tema "lajme nga Kosova dhe rajoni" me 15.5%."

**Televizioni "VIZION +":** Gjatë 3 muajve (shtator – nëntor) të monitorimit të edicioneve kryesore të lajmeve në "Vizion+", është konstatuar pasqyrim i paanshëm dhe i ekilibruar i veprimtarive të forcave politike.

Gjatë kësaj periudhe rreth 41% e kohës televizive në edicionet informative, i është kushtuar veprimtarive të qeverisë dhe pozitës parlamentare, ndërsa rreth 45% e kohës televizive në lajme, i është kushtuar pasqyrimit të veprimtarive të partive opozitare. Nga institucionet, qeveria dhe kryeministri kanë zënë respektivisht 19% dhe 9% të kohës televizive.

Në "Vizion+" personalitetet politikë që i janë drejtuar publikut sinkron me kohën më të madhe janë Edi Rama me 10.6% dhe Sali Berisha me 11.1% të gjithë kohës së përgjithshme sinkron për aktorët politikë.

Tema kryesore e trajtuar në edicionet e "Vizion+" ka qenë tema "sociale" me 22.5%, dukuri specifike për këtë operator në krahasim me subjektet e tjera të monitoruara. Tema "politika" renditet e dyta me 16.3%, dhe në vend të tretë renditet tema "sport" me 11.1%.

Nga krahasimi i të dhënavë të monitorimit rezulton se operatorët e monitoruar rishtas si TCH dhe "Vizion" janë të ekilibruar dhe më të paanshëm sesa operatorë kombëtarë, monitorimi i të cilëve është detyrim ligjor. Më poshtë po paraqesim me tabela të dhënat e monitorimit për subjektet e përshkruara më sipër:

**RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE****PER EDICIONET INFORMATIVE**Koha e Plotën për Subjektet Politike (*koha në %*)

| Subjektet<br>OPERATORI                           | Mars-Nën '07 |         |         | Shtat-Nën '07 |             | Mars-Qer '07 |         |          |
|--|--------------|---------|---------|---------------|-------------|--------------|---------|----------|
|  | TVSH         | TV KLAN | TVA     | TOP CHANNEL   | VIZION PLUS | RADIO TIRANA | TAR     | RADIO +2 |
| PRESIDENTI                                       | 5.74%        | 4.35%   | 4.73%   | 7.20%         | 6.75%       | 7.51%        | 4.19%   | 8.00%    |
| KRYEMINISTRI                                     | 18.53%       | 17.06%  | 10.32%  | 10.99%        | 8.97%       | 16.38%       | 8.00%   | 9.10%    |
| QEVERIA  | 27.82%       | 21.15%  | 18.12%  | 15.85%        | 19.04%      | 15.96%       | 7.97%   | 9.13%    |
| PARLAMENTI                                       | 10.53%       | 8.88%   | 7.36%   | 8.27%         | 8.95%       | 13.07%       | 18.18%  | 19.42%   |
| PARTIA DEMOKRATIKE (PD)                          | 8.11%        | 10.94%  | 9.43%   | 7.76%         | 6.82%       | 11.47%       | 9.35%   | 7.18%    |
| PARTIA SOCIALISTE (PS)                           | 17.93%       | 22.53%  | 27.43%  | 34.53%        | 35.87%      | 19.21%       | 28.53%  | 29.80%   |
| ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)                         | 0.76%        | 1.04%   | 1.64%   | 0.50%         | 0.46%       | 0.68%        | 1.02%   | 0.00%    |
| LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM (LSI)            | 5.22%        | 4.97%   | 7.73%   | 5.98%         | 6.14%       | 6.19%        | 7.38%   | 9.71%    |
| PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)                | 0.13%        | 0.06%   | 0.08%   | 0.00%         | 0.16%       | 0.13%        | 0.64%   | 0.00%    |
| PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)          | 0.07%        | 0.01%   | 0.11%   | 0.00%         | 0.00%       | 0.00%        | 0.00%   | 0.00%    |
| PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ) | 0.34%        | 1.27%   | 1.93%   | 0.84%         | 0.31%       | 0.90%        | 1.67%   | 0.82%    |
| PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERISE (PDSSH)   | 0.87%        | 1.17%   | 1.49%   | 0.75%         | 1.33%       | 0.62%        | 0.84%   | 0.53%    |
| PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)                      | 0.34%        | 0.38%   | 0.62%   | 0.07%         | 0.36%       | 0.94%        | 0.79%   | 1.17%    |
| PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)                       | 1.03%        | 1.90%   | 3.18%   | 3.42%         | 2.13%       | 2.07%        | 4.28%   | 1.75%    |
| PARTIA REPUBLIKANE (PR)                          | 1.42%        | 2.32%   | 2.65%   | 1.70%         | 1.80%       | 2.88%        | 3.31%   | 1.09%    |
| PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)                     | 0.87%        | 1.72%   | 2.76%   | 2.14%         | 0.92%       | 1.69%        | 3.07%   | 2.08%    |
| PARTI TE TJERA                                   | 0.29%        | 0.27%   | 0.41%   | 0.00%         | 0.00%       | 0.31%        | 0.77%   | 0.23%    |
| SHUMA  | 100.00%      | 100.00% | 100.00% | 100.00%       | 100.00%     | 100.00%      | 100.00% | 100.00%  |

**RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE****PER EDICIONET INFORMATIVE**Koha **Sinkron** për Subjektet Politike (**koha në %**)

| Subjektet<br>OPERATORI                                  | Mars-Nën '07 |         |         | Shtat-Nën '07 |             | Mars-Qer '07 |         |          |
|---|--------------|---------|---------|---------------|-------------|--------------|---------|----------|
|   | TVSH         | TV KLAN | TVA     | TOP CHANNEL   | VIZION PLUS | RADIO TIRANA | TAR     | RADIO +2 |
| PRESIDENTI  | 3.73%        | 2.85%   | 3.32%   | 5.16%         | 5.28%       | 3.93%        | 2.20%   | #DIV/0!  |
| KRYEMINISTRI  | 17.08%       | 16.43%  | 9.69%   | 10.52%        | 10.32%      | 21.21%       | 9.46%   | #DIV/0!  |
| QEVERIA   | 28.81%       | 19.64%  | 16.61%  | 16.22%        | 20.94%      | 15.03%       | 9.22%   | #DIV/0!  |
| PARLAMENTI  | 5.90%        | 5.23%   | 4.36%   | 3.47%         | 2.11%       | 3.79%        | 5.59%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA DEMOKRATIKE (PD)</b>                          | 10.40%       | 14.86%  | 10.78%  | 9.09%         | 8.06%       | 14.06%       | 10.85%  | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA SOCIALISTE (PS)</b>                           | 20.06%       | 22.70%  | 30.00%  | 39.25%        | 39.29%      | 25.88%       | 34.92%  | #DIV/0!  |
| <b>ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)</b>                         | 0.94%        | 1.39%   | 1.71%   | 0.54%         | 0.54%       | 0.84%        | 1.44%   | #DIV/0!  |
| <b>LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM (LSI)</b>            | 5.98%        | 5.58%   | 8.65%   | 6.62%         | 5.77%       | 3.91%        | 7.83%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)</b>                | 0.18%        | 0.07%   | 0.03%   | 0.00%         | 0.00%       | 0.15%        | 0.73%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)</b>          | 0.06%        | 0.02%   | 0.17%   | 0.00%         | 0.00%       | 0.00%        | 0.00%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)</b> | 0.44%        | 1.70%   | 2.11%   | 0.88%         | 0.41%       | 1.24%        | 2.15%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERISE (PDSSH)</b>   | 1.15%        | 1.48%   | 1.71%   | 1.03%         | 1.70%       | 0.63%        | 1.02%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)</b>                      | 0.57%        | 0.53%   | 0.70%   | 0.09%         | 0.33%       | 1.02%        | 0.94%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)</b>                       | 1.35%        | 2.20%   | 3.61%   | 3.08%         | 2.25%       | 2.86%        | 5.34%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA REPUBLIKANE (PR)</b>                          | 1.95%        | 3.39%   | 3.17%   | 1.64%         | 1.65%       | 3.53%        | 3.76%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)</b>                     | 1.12%        | 1.81%   | 2.86%   | 2.40%         | 1.35%       | 1.71%        | 3.61%   | #DIV/0!  |
| <b>PARTI TE TJERA</b>                                   | 0.28%        | 0.13%   | 0.52%   | 0.00%         | 0.00%       | 0.21%        | 0.91%   | #DIV/0!  |
| <b>SHUMA</b>  | 100.00%      | 100.00% | 100.00% | 100.00%       | 100.00%     | 100.00%      | 100.00% | #DIV/0!  |

**RAPORT I DREJTORSISË SË PROGRAMeve****PER EDICIONET INFORMATIVE**

Koha **Sinkron** për Aktorët Politikë (**koha në minuta dhe %**)

Mars - Nëntor 2007

| Aktor i Politik     | TVSH     |         |
|---------------------|----------|---------|
|                     | Min      | %       |
| Presidenti          | 41.61    | 3.91%   |
| Kryeministri        | 204.65   | 19.24%  |
| Kryetare e Kuvendit | 32.34    | 3.04%   |
| Kryetari i PS       | 80.50    | 7.57%   |
| Aktorë të Tjerë     | 704.41   | 66.23%  |
| Shuma               | 1,063.51 | 100.00% |

Mars - Nëntor 2007

| Aktor i Politik     | TV KLAN |         |
|---------------------|---------|---------|
|                     | Min     | %       |
| Presidenti          | 30.22   | 3.18%   |
| Kryeministri        | 185.88  | 19.57%  |
| Kryetare e Kuvendit | 17.44   | 1.84%   |
| Kryetari i PS       | 66.05   | 6.96%   |
| Aktorë të Tjerë     | 650.06  | 68.45%  |
| Shuma               | 949.65  | 100.00% |

Mars - Nëntor 2007

| Aktor i Politik     | TVA    |         |
|---------------------|--------|---------|
|                     | Min    | %       |
| Presidenti          | 26.45  | 3.45%   |
| Kryeministri        | 97.96  | 12.80%  |
| Kryetare e Kuvendit | 10.73  | 1.40%   |
| Kryetari i PS       | 62.86  | 8.21%   |
| Aktorë të Tjerë     | 567.59 | 74.14%  |
| Shuma               | 765.59 | 100.00% |

Shtator - Nëntor 2007

| Aktor i Politik     | VIZION + |         |
|---------------------|----------|---------|
|                     | Min      | %       |
| Presidenti          | 12.72    | 5.22%   |
| Kryeministri        | 27.09    | 11.13%  |
| Kryetare e Kuvendit | 2.93     | 1.20%   |
| Kryetari i PS       | 25.85    | 10.62%  |
| Aktorë të Tjerë     | 174.88   | 71.83%  |
| Shuma               | 243.47   | 100.00% |

Shtator - Nëntor 2007

| Aktor i Politik     | TOP CHANNEL |         |
|---------------------|-------------|---------|
|                     | Min         | %       |
| Presidenti          | 18.65       | 5.10%   |
| Kryeministri        | 43.35       | 11.85%  |
| Kryetare e Kuvendit | 8.02        | 2.19%   |
| Kryetari i PS       | 45.27       | 12.38%  |
| Aktorë të Tjerë     | 250.51      | 68.48%  |
| Shuma               | 365.80      | 100.00% |

**RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE****PER EDICIONET INFORMATIVE**Koha **Sinkron** për Aktorët Politikë (**koha në minuta dhe %**)Mars - Qershori 2007

| Aktor i Politik     | R. TIRANA |         |
|---------------------|-----------|---------|
|                     | Min       | %       |
| Presidenti          | 11.42     | 4.11%   |
| Kryeministri        | 71.40     | 25.73%  |
| Kryetare e Kuvendit | 4.34      | 1.56%   |
| Kryetari i PS       | 36.91     | 13.30%  |
| Aktorë të Tjerë     | 153.47    | 55.30%  |
| Shuma               | 277.54    | 100.00% |

Mars - Qershori 2007

| Aktor i Politik     | TAR    |         |
|---------------------|--------|---------|
|                     | Min    | %       |
| Presidenti          | 4.49   | 3.40%   |
| Kryeministri        | 16.89  | 12.80%  |
| Kryetare e Kuvendit | 2.35   | 1.78%   |
| Kryetari i PS       | 17.77  | 13.47%  |
| Aktorë të Tjerë     | 90.47  | 68.55%  |
| Shuma               | 131.97 | 100.00% |

Mars - Qershori 2007

| Aktor i Politik     | RADIO +2 |         |
|---------------------|----------|---------|
|                     | Min      | %       |
| Presidenti          | #DIV/0!  |         |
| Kryeministri        | #DIV/0!  |         |
| Kryetare e Kuvendit | #DIV/0!  |         |
| Kryetari i PS       | #DIV/0!  |         |
| Aktorë të Tjerë     | 0.00     | #DIV/0! |
| Shuma               |          | #DIV/0! |

**RAPORT I DREJTORISË SË PROGRAMEVE****PËR EDICIONET INFORMATIVE**Koha e Plotë për Temën e Lajmit (*koha në %*)

| TEMA<br>OPERATORI                 | Mars - Nëntor '07 |         | Shtator - Nëntor '07 |             | Mars - Qershor '07 |              |         |          |
|-----------------------------------|-------------------|---------|----------------------|-------------|--------------------|--------------|---------|----------|
|                                   | TVSH              | TV KLAN | TV ARBERIA           | TOP CHANNEL | VIZION PLUS        | RADIO TIRANA | TAR     | RADIO +2 |
| 01.POLITIKA                       | 20.39%            | 26.41%  | 18.60%               | 22.93%      | 16.37%             | 29.47%       | 24.30%  | 18.81%   |
| 02.VEPRIMTARIA E PRESIDENTIT      | 1.29%             | 0.86%   | 0.90%                | 1.53%       | 1.34%              | 2.72%        | 1.20%   | 1.41%    |
| 03.VEPRIMTARIA E QEVERISË         | 5.92%             | 4.82%   | 1.89%                | 3.07%       | 2.69%              | 7.90%        | 2.28%   | 2.63%    |
| 04.VEPRIMTARIA E PARLAMENTIT      | 5.02%             | 4.53%   | 2.96%                | 3.57%       | 3.29%              | 6.27%        | 7.30%   | 3.50%    |
| 05.VEPRIMTARIA E QEVERISË VENDORE | 1.42%             | 0.96%   | 0.68%                | 1.38%       | 1.05%              | 0.51%        | 0.37%   | 0.29%    |
| 06.VEPRIMTARIA E DREJTËSISË       | 1.06%             | 2.93%   | 1.37%                | 3.51%       | 2.75%              | 0.73%        | 1.46%   | 1.73%    |
| 07.SOCIALE                        | 21.66%            | 13.71%  | 17.51%               | 17.09%      | 22.54%             | 8.48%        | 12.74%  | 14.75%   |
| 08.EKONOMI                        | 8.06%             | 5.40%   | 5.00%                | 6.91%       | 8.00%              | 9.47%        | 7.61%   | 4.64%    |
| 09.KRONIKA E ZEZË / RENDI         | 1.98%             | 5.48%   | 4.91%                | 5.73%       | 8.12%              | 2.98%        | 7.20%   | 19.03%   |
| 10.LAJME NGA KOSOVA / RAJONI      | 9.79%             | 9.04%   | 12.10%               | 15.15%      | 7.86%              | 10.85%       | 14.12%  | 12.34%   |
| 11.LAJME NDËRKOMBËTARE            | 5.41%             | 8.69%   | 14.23%               | 7.04%       | 7.53%              | 10.85%       | 13.71%  | 17.42%   |
| 12.ART / KULTURË                  | 10.85%            | 9.10%   | 5.78%                | 4.61%       | 6.79%              | 3.46%        | 1.41%   | 1.68%    |
| 13.SPORT                          | 6.72%             | 7.51%   | 14.00%               | 6.87%       | 11.10%             | 6.25%        | 3.66%   | 1.70%    |
| 14.TË TJERA                       | 0.46%             | 0.56%   | 0.06%                | 0.60%       | 0.57%              | 0.07%        | 2.66%   | 0.07%    |
| <b>SHUMA</b>                      | 100.00%           | 100.00% | 100.00%              | 100.00%     | 100.00%            | 100.00%      | 100.00% | 100.00%  |

Sic vërehet nga përshkrimi i mësipërm, periudha janar – shkurt 2007 nuk përfshihet në periudhën e monitorimit të medias elektronike. Kjo ndodh për arsy se gjatë kësaj kohe është zhvilluar fushata për zgjedhjet vendore, monitorimi i së cilës është realizuar në mjediset e KKRT-së, nga specialistët e Departamentit të Programeve në KKRT dhe i ndjekur nga Bordi i Monitorimit të ngritur nga KQZ. E shohim të nevojshme të theksojmë përfundimet e këtij monitorimi, e paralelisht të ngremë edhe problemet që kanë të bëjnë me rregullimet e mundshme ligjore, në kuadrin e reformës zgjedhore.

Në raportin për zgjedhjet e 18 Shkurtit 2007, për organet e qeverisjes vendore, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, thekson: "Media elektronike dhe ajo e shkruar i pasqyruan gjerësisht zgjedhjet. Ndonëse para fillimit të fushatës zgjedhore, media elektronike favorizonte qartësisht parti të caktuara,

pasqyrimi i veprimitarive të tyre u bë më i baraspeshuar gjatë periudhës së fushatës zyrtare".

Më poshtë në raport theksohet se: "Fushata në media u duk të përqendrohej në personalitetet dhe jo në platforma politike, ku dy partitë kryesore zunë pjesën më të madhe të minutazhit. Megjithëse media e rriti paksa minutazhin për partitë e vogla gjatë periudhës zyrtare të fushatës, përgjithësisht, dy partitë kryesore politike vazhduan të mbizotëronin.

Para periudhës zyrtare të fushatës, operatori publik, TVSH-ja, i dha PD-së 32 për qind të minutazhit politik në lajmet kryesore, kryesisht në ton pozitiv dhe neutral, ndërsa PS-ja mori 23 për qind, me shkallë përafërsisht të njëjtë informacioni pozitiv dhe negativ. Gjatë periudhës së fushatës, operatori publik i pasqyrojoi të dyja partitë në mënyrë të barabartë, duke i dhënë 28 për qind PD-së dhe 29 për qind PS-së.

Prirje të ngjashme u vunë re në operatorët privatë "Vizioni+" dhe "News 24", ku PS-ja mori në mënyrë të konsiderueshme më shumë kohë se PD-ja para fillimit të fushatës, por minutazhi u bë më i baraspeshuar gjatë periudhës së fushatës.

Një tjetër televizion privat, TV "Arbëria", u dha partive kryesore politike pak a shumë të njëjtën shkallë pasqyrimi pozitiv dhe neutral, si para edhe gjatë periudhës së fushatës, por ndryshe nga operatorë të tjerë, i dha më shumë kohë partive të tjera, në veçanti LSI-së.

Para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, televizioni privat, TV Klan, i dha PS-së 29 për qind të minutazhit me pasqyrim në pjesën më të madhe neutral dhe negativ, krahasuar me 19 për qind me pasqyrim kryesisht neutral për PD-në. TV Klan i kushtoi më shumë kohë Qeverisë (27 për qind) se çdo operator tjetër i monitoruar nga MVZ-ja. Kjo qasje nuk ndryshoi ndjeshëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës dhe operatori vazhdoi të paraqesë zyrtarët e shtetit si përfaqësues të qeverisë, edhe kur ata merrnin pjesë në veprimitari të fushatës.

Nga sa vërehet më sipër e ndjejmë të nevojshme të theksojmë se, në kushtet e një KKRT-je të formatuar me konsensus nga Kuvendi i Shqipërisë dhe duke pasur parasysh se i gjithë procesi i monitorimit kryhet në mjediset e KKRT-së dhe infrastrukturën e saj, propozojmë ndryshimin e Kodit Zgjedhor të RSH edhe në lidhje me monitorimin e medias elektronike. Kjo detyrë t'i lihet KKRT-së, si institucioni i vetëm që rregullon veprimitarinë e medias elektronike në Shqipëri.

### 3.3 *Etika në media*

Një detyrë e rëndësishme e KKRT-së e përcaktuar në ligjin “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, mbetet monitorimi i respektimit nga media elektronike, i normave etiko-morale në transmetimet e programeve radiotelevizive.

Këshilli i Etikës, i ngritur kohët e fundit në KKRT, e që zëvendësoi Këshillin e Ankesave, ka filluar të trajtojë me seriozitet problemet e shfaqjes pa kriter të dhunës në ekran, pamjeve të theksuara erotike, dukurive të diskriminimit të personalitetit dhe cënimit të privatësisë, mbrojtjes së fëmijëve dhe adoleshentëve nga “rreziku mediatik”, abuzimit me gjuhën e folur dhe përdorimin e një fjalori vulgar në disa prej programeve televizive të transmetuara.

Këshilli i Etikës përbëhet nga 3 anëtarë me një mandat 3 vjeçar. KKRT zgjodhi si anëtarë të Këshillit të Etikës zotérinjtë Fatos Lubonja, Bashkim Hoxha dhe Remzi Lani. Veprimtaria e Këshillit të Etikës u shoqërua me përpilimin e akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e tij. Veç këtyre, Këshilli i Etikës është në fazën përgatitore të një Tryeze të Rrumbullakët në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe transmetimit nga media elektronike të filmografisë televizive dhe kinematografike të prodhuar në kohën e diktaturës.

Një nga nismat aktuale të Këshillit të Etikës është hartimi nga çdo operator radioje ose televizioni i një kodi etik në përputhje me standartet e pranuara sot gjerësisht e që është një marrëveshje me publikun për normat etiko-morale që çdo subjekt radioteleviziv synon të arrijë.

Në të ardhmen presupozohet që këto kode të secilit operator, me trajnimin dhe koordinimin e Këshillit të Etikës, të unifikohen në një kod të përbashkët, i cili të jetë një akt i brendshëm dhe normativ i pranuar nga të gjithë operatorët, për respektimin e kërkesave ligjore, të normave etike dhe morale të komunikimit përmes ekranit.

### Radiotelevizioni Publik Shqiptar

Radio dhe televizioni shqiptar është institucioni që kryen shërbimin publik në fushën e transmetimeve. Ligji dhe statusi i RTSH-së krijojnë hapësira për ndryshime në strukturën programore dhe cilësinë e programeve, që ato t'i shërbejnë me të vërtetë publikut të gjerë.

Gjatë vitit 2007, në përpjekje për të përballuar konkurrencën e ashpër me transmetuesit privatë, TVSH hoqi dorë nga ritransmetimet në masë të programeve arkivore.

Struktura programore pësoi përmirësime të ndjeshme. Krahasuar me një vit më parë, struktura aktuale e programeve të TVSH ka ndryshuar në këto drejtime. U katërfishua prodhimi i programeve të reja të transmetuara në ekran. Rreth 68% e emisioneve janë të produara vetë nga TVSH ose bashkëprodhime, në një kohë kur në fund të vitit 2006, kjo shifër nuk e kalonte 20%.

Strukturimi i kohës kryesore televizive në të gjitha ditët e javës nëpërmjet emisioneve të reja si "7x7", "Të kam zemër", "Sfida dhe strategji", "Përballë", ristrukturimi i "Rubrikës Sportive", dikur e suksesshme në TVSH, dhe spektakli "Kthehem të dielën", transmetimi gjatë vitit 2007 i rreth 90 dokumentarëve dhe telereportazheve të reja, kanë krijuar një fisionomi të re të strukturës programore të këtij operatori.

Vërehet ristrukturimi i programeve për fëmijë dhe të rinj. Njëri prej formave më të suksesshme të TVSH-së në këtë kategori, si "Troç", është shoqëruar me katër formate të reja, të cilat marrin përsipër t'u drejtohen grupmoshave të ndryshme si "Të zgjidhura dhe të pazgjidhura", "Fokus fëminor", "Prokat" dhe "Çanta e së dielës".

Në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore, televizioni publik ka filluar të ofrojë disa formate të reja, të cilat i përgjigjen interesave të shtresave dhe grupimeve të ndryshme të popullsisë, si "Skaner", me trajtesa investiguese për problemet më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare sot, "Takim me kinemanë", që u referohet risive të javës kinematografike në kryeqytet, "Katalogu kulturor", i cili ofron përbledhjen e ngjarjeve kulturore të javës, "Planeti muzikor", i cili ofron njoħuri dhe zbulon biografi të lidhura me lëvrimin e gjinive të ndryshme të muzikës klasike etj.

Edhe në drejtim të faqosjes dhe promocionit, TVSH ka ndryshuar ndjeshëm në krahasim me një vit më parë. Është përmirësuar ritmi dhe dinamika e paraqitjes grafike, duke u pasuruar gjithnjë e më tepër me elementë bashkëkohorë.

Ndryshe është paraqitur edhe Radio Tirana gjatë vitit 2007 në fushën programore. Vërehet rikthimi i disa gjinive radiofonike në valët e programit të parë dhe gradualisht kjo gjë është arritur edhe te programi i dytë dhe i tretë i Radios publike.

Në fillim të vitit 2007 filloi transmetimi i shumë emisioneve me pikësynimin për të krijuar një imazh të ri të programeve radiofonike. Ndër emisionet e reja dhe të suksesshme mund të përmendim: "Nata nuk do t'ia dijë", emisioni informativ social-kulturor "Stop", emisioni i përditshëm "Tjetër mëngjes", cikli i dokumentarëve radiofonikë të përvjavshëm "Rrjedha të kulturës" me objekt kulturën mbarëkombëtare shqiptare, si dhe ai me titull "Vatra", që pasqyron veprimtarinë e familjeve të mëdha e të traditës shqiptare, kontributin e tyre në mbijetesën e kombit tonë.

"Drita e diturisë" titullohet emisioni favor që trajton emrat e mëdhenj të arsimit kombëtar shqiptar. Të tjera emisione që kanë sjellë larmi tematike në valët e Radio Tiranës janë "Peizazhe fshati", "Realitetë ekonomike" dhe "Individ, turizmi e shteti", cikli "Të jesh Grua" si dhe programi muzikor "Nostalgji".

Muzika, është gjinia që zë rreth 65% të strukturës programore në Radio Tirana. Gjatë vitit 2007 iu rikthyte dëgjuesit "Maratona e këngës" së muzikës së lehtë shqiptare dhe një sërë programesh të tjera muzikore dhe argëtuese.

Viti 2007 ishte periudhë ndryshimi edhe për programin e dytë të Radio Tiranës. U konsoliduan një numër i konsiderueshëm emisionesh, kryesisht muzikore dhe kulturorë.

Për bashkatdhatarët dhe në gjuhë të huaj transmetohen disa programe të reja, ndër të cilat përmendim ciklin e gjuhës shqipe për emigrantët, turizmi historik e kulturor si dhe politikat e emigracionit etj. Radio Tirana është sot konkurrent potencial i radiove private komerciale.

Megjithëse ndryshimet në strukturën dhe përbajtjen programore të RTSH-së kanë filluar, ende është bërë pak për të kënaqur shijet dhe interesat e gjithë publikut, për informimin, edukimin dhe argëtimin e tij.

## 4 OPERATORËT RADIO E TELEVIZIVË

“Ka progres në fushën e **politikës audio-vizuale**. KKRT mori masa rigorozë kundër operatorëve televizive privatë që transmetonin jashtë zonës së tyre të licencimit. Megjithatë, burimet njerëzore dhe financiare të KKRT-së mbeten të kufizuara, në mënyrë të veçantë përsa i përket shpërndarjes së frekuencave, parandalimit të zënies pirate të frekuencave, luftës kundër piraterisë në të drejtën e autorit dhe monitorimit të transmetuesve”. (Raporti i Komisionit Evropian 2007)

Konstatimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë janë reflektimi i menjëhershëm i masave energjike të ndërmarra nga KKRT gjatë vitit 2007 për stabilizimin e vendosjen mbi baza ligjore të veprimtarisë së transmetimeve radio e televizive në vend. KKRT, e inkurajuar nga arritet mbresëlënëse të realizuara edhe me mbështetjen e opinionit publik, politikës dhe organeve shtetërore, ka ndërmarrë një seri masash për ristrukturimin, rritjen e kapaciteteve teknike e administrative dhe përmirësimin e efikasitetit rregullator.

Në këtë kuadër, KKRT ka marrë pjesë aktivisht në diskutimin e ligjit të ri për shërbimet numerike (digitale) që u miratua nga Kuvendi dhe aktualisht po përfundon rregulloren e Licencimit të rrjeteve dhe shërbimeve numerike, që pritet të miratohet së shpejti.

Në zbatim të misionit të tij, edhe gjatë vitit 2007 Këshilli ka vazhduar përpjekjet konkrete për finalizimin e Planit Kombëtar të Frekuencave Televizive në zbatim të Marrëveshjes GE06 të nënshkruar në Konferencën e Radiokomunikacioneve, Gjenevë, Qershor 2006.

### 4.1 *Televizioni publik*

“Programet e RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90% e shtetasve të Republikës së Shqipërisë. Brenda 5 vjetësh nga dita e miratimit të këtij ligji, të paktën njëri nga programet e RTSH-së duhet të mbulojë 99% të popullsisë”.<sup>1</sup>

RTSH vazhdon të transmetojë vetëm 1 program televiziv kombëtar (programi I) të mbështetur në transmetues të teknikës analoge duke mbuluar 73.31 % të territorit shqiptar.

---

<sup>1</sup> Ligji “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, nen 71

Ndërtimi i rrjetit analog ku do të mbështetet programi i dytë, i parashikuar nga ligji në fuqi, është konsideruar i tejkaluar, në kushtet kur përgatitjet për fillimin e transmetimeve numerike janë në përfundim.

Gjendja e Operatorit Publik paraqitet e përmirësuar nga vitet e kaluara, por vitin e kaluar janë hasur edhe probleme e vështirësi, të shkaktuara nga gjendja e vjetëruar e ambienteve teknike, pajisjeve dhe aparaturave, etj. Kjo gjendje ka krijuar anomali ne realizimin e mbulimit cilësor me sinjal të territorit të Republikës. Një shkak shtesë që influencon në reduktimin e territorit të mbuluar me sinjal është dhe mënyra e administrimit të përsëritësve të komunave që aktualisht janë në varësi të vetë komunave. Kjo arsy, plus mungesa e energjisë, ka bërë që shumë zona të largëta të mos marrin sinjalin e RTSH-së për periudha relativisht të gjata kohe.

Një problem shumë shqetësues vazhdon të përbëjë stabilizimi i financimit të RTSH. Përveç sigurimit të fonave nga buxheti i shtetit, një e ardhur e konsiderueshme do të mund të sigurohej nëse do të përcaktoheshin më drejt mekanizmat e vjeljes nga përdoruesit (familjarë e biznes) të taksës vjetore për televizionin.

Në takimet e organizuara midis KKRT dhe RTSH, gjatë diskutimit të përmirësimit të mbulimit me sinjal, është trajtuar në mënyrë të veçantë përmirësimi imediat i mbulimit të disa zonave të Shqipërisë së Jugut, sidomos i zonës së Bregut, ku mbizotërojnë sinjalat e fuqishme të televizioneve greke. Me këtë rast është theksuar nevoja e stabilizimit të stacionit transmetues të RTSH të instaluar në marrëveshje me palën greke në ishullin e Korfuzit. Për vetë pozicionin e tij gjeografik përballet fshatrave të bregut ky transmetues ka funksion kyç në rrjetin e mbulimit të RTSH. Por operimi i tij, ka ndodhur që të variojë në varësi të disa problemeve jo të karakterit teknik që kanë ndodhur ndonjëherë midis dy vendeve tona. KKRT dhe RTSH janë të mendimit se ky problem mund të stabilizohet në bisedime me organin rregulator grek dhe operatorin e tyre publik (ERT), bazuar në parimin e reciprocitetit.

Me kohë<sup>2</sup>, KKRT ka sugjeruar shqyrtimin e mundësisë që, në vend të ndërtimit të rrjetit analog për programin e dytë të RTSH, të planifikohet ndërtimi i një rrjeti numerik, mbi të cilin do të mbështeten, programi i parë dhe programi i dytë duke krijuar njëkohësisht mundësinë e transmetimit të disa programeve tematikë.

Propozohet që shqyrtimi, i shoqëruar me një studim fizibiliteti të kryhej nga vetë specialistët e RTSH, të mbështetur edhe në ekspertizë të huaj. Këtë vit, në takimet e shpeshta KKRT-RTSH, me interes të veçantë është trajtuar çështja e zhvillimit imediat të rrjeteve të transmetimit të RTSH.

---

<sup>2</sup> Shih "Raport i KKRT për vitin 2006"

Nga të dyja palët është pranuar se tashmë, në kushtet kur është përcaktuar me ligj data e mbylljes së transmetimeve analoge (2012), zhvillimi në drejtim të instalimit të rrjeteve analoge është problem i tejkaluar. Duke qenë se kushtet ligjore dhe rregullatore diktojnë ndërtimin e rrjeteve numerike, Operatori publik, siç rekomandohet gjerësisht edhe në direktivat e BE, duhet të vihet në pararojë të numerizimit.

Në këtë kontekst, KKRT dhe RTSH kanë diskutuar gjerësisht idenë e fillimit të ndërtimit të rrjeteve numerike të TVSH, duke filluar nga allotamenti i Tiranës, në zbatim të eksperiencës gjermane të krijimit të "ishujve numerikë".

Ndërtimi i rrjeteve numerike të TVSH do të ndihmojë edhe në konvertimin numerik të disa operatorëve ekzistues analogë të cilët do të specializohen vetëm për prodhimin e programeve, duke u çliruar nga barra e kushtueshme e mirëmbajtjes së rrjetit. Mendimi është që kjo ide mund të vihet në praktikë brenda viti 2008, me kusht që të sigurohen fondet përkatëse. RTSH tashmë disponon një parashikim buxhetor të ndërtimit të rrjeteve të saj numerike për mbulimin e Shqipërisë i cili mund të detajohet sipas planit të implementimit që do të hartohet mbështetur në idenë e mësipërme të "ishujve numerike".

Paraprakisht ekzistojnë disa ide për sigurimin e financimeve për ndërtimin e rrjeteve numerike të operatorit publik, përfshirë edhe financime të kombinuar me subjekte private. Formulimi i një propozimi të saktë për financimin e ndërtimit të rrjeteve numerike mbetet të përcaktohet pas konsultimesh edhe me institucione të tjera qeveritare kompetente, ku do të detajohen fazat e implementimit me fondet përkatëse.

Mendimi unanim i KKRT dhe RTSH është se ekzistojnë të gjitha mundësítë që deri në fund te 2008 zona Tirane-Durrës të mbulohet me sinjal numerik të TVSH duke mundësuar transmetimin *simulcast* të programit të parë të RTSH, krijimin e programit të dytë të TVSH dhe transmetimin e programeve të disa operatorëve të tjere ekzistues analoge duke përgatitur kushtet për lirimin e spektrit të rënduar me transmetime analoge të këtij rajoni.

Për vetë RTSH ndërtimi i rrjetit numerik në rajonin e Tiranës do të lirojë kanalet që aktualisht përdoren për transmetime analoge që janë:

- Transmetuesin në kanalin 11 VHF;
- Transmetuesin në kanalin 57 UHF;
- Transmetuesin në bandën C

që përdoret për të furnizuar me sinjal primar një numër përsëritësish, duke lënë në punë përkohësisht vetëm 1 prej tyre për transmetimin *simulcast* të programit të parë të RTSH.

#### 4.2 Operatorët kombëtarë

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

| Nr | Operatori  | Zona e Licencimit | Mbulimi                 |                |                          |                |                         |                |                        |                |                         |                |
|----|------------|-------------------|-------------------------|----------------|--------------------------|----------------|-------------------------|----------------|------------------------|----------------|-------------------------|----------------|
|    |            |                   | Dhjetor 2002<br>Viti II |                | Dhjetor 2003<br>Viti III |                | Dhjetor 2004<br>Viti IV |                | Dhjetor 2005<br>Viti V |                | Dhjetor 2006<br>Viti VI |                |
|    |            |                   | Kush tet e licenc.      | Mbulimi faktik | Kush tet e licenc.       | Mbulimi faktik | Kush tet e licenc.      | Mbulimi faktik | Kush tet e licenc.     | Mbulimi faktik | Kush tet e licenc.      | Mbulimi faktik |
| 1  | TVSH       | K                 | -                       | 73.31          | -                        | 73.31          | -                       | 73.31          |                        | 73.31          |                         | 73.31          |
| 2  | TV ARBERIA | K                 | 7.33                    | 27.39          | 26.4                     | 30.1           | 46.97                   | 30.1           | 62.09                  | 30.1           | 75.71                   | 30.1           |
| 3  | TV KLAN    | K                 | 7.33                    | 40.91          | 26.4                     | 42.68          | 46.97                   | 42.68          | 62.09                  | 42.68          | 75.71                   | 44.53          |
| 4  | R. TIRANA  | K                 | -                       | 80.54          | -                        | 80.54          | -                       | 80.54          |                        | 80.54          |                         | 80.54          |
| 5  | R. T.ALB.  | K                 | 28.85                   | 87.22          | 55.76                    | 87.22          | 72.69                   | 87.22          | 94.4                   | 87.22          | 100                     | 87.22          |
| 6  | RADIO + 2  | K                 | -                       | -              | 55.76                    | 72.64          | 72.69                   | 72.64          | 94.4                   | 72.64          | 100                     | 72.64          |

Mbulimi i RTSH është dhënë i pandryshuar në vite, pasi nuk janë raportuar apo identifikuar ndryshime të rrjetit bazë të transmetimit, Vënia në punë e stacioneve në UHF ka dubluar mbulimin në zona tashme të mbuluara dhe nuk e ka zgjeruar atë në zona të largëta.

Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB ( $\mu\text{V/m}$ )

Mbulimi i realizuar nga TVA dhe KLAN deri në fund të Vitit 2007

| Nr | Operatori  | Zona e Licencimit | Mbulimi i territorit të Republikës |                |  |                |
|----|------------|-------------------|------------------------------------|----------------|--|----------------|
|    |            |                   | Dhjetor 2006<br>Viti VI            |                | Gjendja deri në Shtator 2007<br>Viti VII |                |
|    |            |                   | Kushtet e licenc.                  | Mbulimi faktik | Kushtet e licenc.                        | Mbulimi faktik |
| 1  | TVSH       | K                 |                                    | 73.31          |  | 79.19          |
| 2  | TV ARBERIA | K                 | 75.71                              | 30.1           | 86.8 %                                   | 45.8           |
| 3  | TV KLAN    | K                 | 75.71                              | 44.53          | 86.8 %                                   | 46.53          |
| 4  | R. TIRANA  |                   |                                    | 80.54          |  | 80.54          |
| 5  | R. T.ALB.  |                   | 100                                | 87.22          | 100                                      | 87.22          |
| 6  | RADIO + 2  |                   | 100                                | 72.64          | 100                                      | 72.64          |

Një punë voluminoze ka zhvilluar TVA për të plotësuar boshllëqet e viteve të kaluara. Sic shihet nga tabela ky subjekt ka realizuar një rritje te konsiderueshme te mbulimit, por pa arritur treguesit e kerkuar nga kushtet e licences. KKRT eshte duke verifikuar mbulimin e realizuar nga TVA

Viti 2007 ishte viti i shtatë i licencsimit të operatorëve kombëtarë.

Ligji "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" (Neni 20), përcakton:

**"Mbajtësi i licencës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e mbi 70 % të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë deri në 90 % të territorit dhe jo më pak se 90 % të popullsisë".**

Nga ana e KKRT, operatorët përkatës janë paralajmëruar disa herë (duke vendosur edhe sanksione) që këto mosrealizime do të merren në konsideratë gjatë shqyrtimit të rinnovimit të licencës (që do të realizohet në vitin 2008).

Sipas kushteve të licencës,

**(1) I licensuari duhet të realizojë lidhje stacionare radiorele me jo më pak se 4 (katër) qytete të Shqipërisë të cilët ndodhen jo më pak se 100 km larg Tiranës.**

**(2) Këto lidhje duhet të realizohen jo më vonë se 18 muaj nga koha e fillimit të transmetimit.(Detyrimi për lidhje me disa rrethe të Shqipërisë)**

TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.

#### 4.3 Operatorët vendorë dhe mbulimi i realizuar

Gjatë vitit 2007, në përputhje me kërkesat e paraqitura, KKRT në vazhdim të strategjisë për rregullimin e shfrytëzimit të frekuencave dhe për futjen e transmetimeve numerike është përpjekur të orientojë ngritjen e operatorëve vendore radio dhe televizive në zonat e largëta ku nevojat për informacion e argëtim në gjuhën shqipe janë më të mëdha dhe ku shfrytëzimi i spektrit nuk është i ngarkuar.

Nuk ka munguar edhe vullneti i KKRT-së për të lëshuar licensa operimi edhe në zonat e ngarkuara, në favor të nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe për të shmangur monopolet. Por siç është theksuar edhe vitin e kaluar, megjithë përpjekjet e KKRT për krijimin e lehtësirave, për nxitjen e mbulimit të zonave të largëta, nuk kanë dhënë gjithmonë rezultatin e pritur. Është për t' u përmendur rasti i operatorit radio dhe TV "Armonia" i konceptuar si media për zonën e

minoritetit grek në jug të Gjirokastrës i cili akoma nuk ka dalë në transmetim me gjithë nxitjet e shpeshta të KKRT-së.

Në përpjekje për të realizuar, mundësishët të gjitha kërkesat për t'u licencuar si operatorë vendorë radio e televizive, KKRT ka organizuar kandidime kandidaturash dhe ka lëshuar lënsa të reja si operatorë radio apo televizive, kryesisht operatorë të vegjël lokale, ose zgjerime të vogla të operatorëve ekzistues, duke punuar në paralel me përfundimin e Planit Final të Frekuencave.

Informacioni për mbulimin e realizuar nga secili prej operatorëve radio apo televizivë te licencuar, jepet bashkëngjitur. Në përgjithësi, shumë prej operatorëve të licencuar, sidomos ata televizive, nuk i mbulojnë plotësisht zonat e tyre te licencimit.

Operatorët që rezultojnë me mbulim më të ulët janë:

- TV Gramshi-7.2 % (I njëjtë me vitin e kaluar)
- TV Berati-6.2 % (I njëjtë me vitin e kaluar)

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

- Tirana TV- 42%,
- Supersonic (Ish Adriatik) 61 %,
- Vizon + 56.69%,

Televizione me mbulim të mirë (Mbi 70%)

UFO (ish Teuta TV) 78.3 % si dhe disa TV të vogla, (TV 4+, Klodianë)

Edhe këtë vit nuk ka operatorë që kanë përmirësuar ndjeshëm mbulimin me sinjal të zonës së tyre të licencimit. Në fushën e transmetimeve radio, për vetë karakteristikat e përhapjes së sinjalit në brezin e FM, mbulimi i zonës së licencimit paraqitet më i mirë.

#### *4.4 Mbyllja e transmetimeve jashtë zonës së tyre të licencimit*

Një nga arritjet e KKRT-së lidhur me zbatimin e ligjit është mbyllja e impianteve jashtë zonave të licencimit të operatorëve privatë vendorë radiotelevizivë, problem që vazhdonte të ekzistonte prej vitesh.

Lidhur me këtë, vlen të kujtojmë dhe theksojmë se KKRT e ka filluar veprimtarinë e saj duke gjetur shumicën e operatorëve aktualë në transmetim. Këta operatorë, kryesisht të përqendruar në Tiranë dhe Ultësirën Perëndimore, përdornin breza frekuencash të okupuara arbitralisht, disa prej tyre edhe dy deri në tre kanale në të njëjtën zonë mbulimi. Pavarësisht licencimeve që bëri KKRT, shumë operatorë televizivë vazhduan të mbanin të instaluar impiantet e tyre transmetues dhe operatorët e rinj shtuan transmetues në zona me shtrirje gjeografike më të gjerë se territori maksimal i lejuar nga ligji ekzistues për operatorët vendor.

Shkelje tjetër e evidentuar rëndom, gjatë vitit 2007 ka konsistuar në daljen në transmetim pa autorizimin apo licencimin e KKRT-së, shkelje kjo e vërejtur në një masë të konsiderueshme në transmetimin e programeve me kabëll. Në këto kushte, Drejtoria Juridike dhe e Liçensave, në bashkëpunim me Drejtorinë Teknike kanë konstatuar dhe propozuar vendosjen e sanksioneve me gjobë për subjektet të cilët kanë shkelur ligjin.

Konkretnisht, gjatë muajit tetor, grupi i inspektorëve të KKRT-së ushtroi kontroll dhe identifikoi disa televizione kabllorë të palicencuar në qytetet Vorë, Marikaj, Sukth, Dushk, Divjakë, Novoselë, Selenicë, Orlikum, Himarë, Ksamil, Konispol, Shëngjin, Vau i Dejës.

Për këtë kundërvajtje administrative, të parashikuar në nenin 137/4 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kahas vendosjes së sanksionit me gjobë, dolën edhe urdhrat përkatës për mbylljen e tyre me vulosje.

Pothuajse të gjithë këto subjekte televizivë privatë kabllorë, të cilët dolën në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, tashmë nuk ekzistojnë, pasi këto televizione janë mbyllur, në rastet e mosmbylljes vullnetare, nëpërmjet organeve të Policisë Tatimore, si organ i ngarkuar nga ligji për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së lidhur me sanksionet me gjobë dhe heqjes së licencave.

Bashkëngjitur jepet skematikisht gjendja e mbulimit të realizuar nga të gjithë operatorët radio e televizive të licencuar. Nga krahasimi me të dhënat e vitit të kaluar, shihet se gjendja e transmetimeve jashtë zonës së licencimit ka ndryshuar rrënjosht. Ndërsa në Raportin e vitit të kaluar figuronin shumë operatorë që kishin instaluar pajisje transmetuese jashtë zonave të tyre të liçensimit, sot mund të deklarojmë se në fund të vitit 2007 të gjithë operatorët lokale të licencuar nga KKRT mbulojnë me sinjal vetëm zonat përfshirë janë autorizuar të ofrojnë shërbim. Kjo gjendje përbën një bazë të shëndoshë për regullimin e tregut mediatik dhe funksionimin normal të mekanizmave të tij.

Zgjerimi i zonës së mbulimit tej zonës së përcaktuar në liçensë nga shumë operatorë ka qenë një shqetësim konstant i KKRT-së. Për të kufizuar zgjerimin e paautorizuar të zonës së mbulimit dhe me qëllim që të mos përkeqësohej gjendja e shfrytëzimit të spektrit dhe të uleshin interferencat e dëmshme, KKRT, sidomos gjatë vitit 2007, ka kërkuar nga operatorët respektimin e ligjit. Për këtë qëllim janë ezauruar njoftime, vërejtje, paralajmërimi, gjoba, madje edhe bllokime dhe sekuestrime pajisjesh.

Në fillim të vitit 2006 KKRT-ja e kaluar, ri-liçensoi edhe operatorë që kishin instaluar impiante jashtë zonës së tyre të liçensimit (TV Top Channel, TV Telesport, TV Koha, TV Vizioni +), duke shkelur kërkesën ligjore për respektimin

e kushteve të licencës. Ri-licensimi i tyre u realizua me kusht që ata të mbyllin të gjitha impiantet e instaluara jashtë zonës së licencimit brenda 31 Dhjetorit 2006. Ky vendim i KKRT-së nuk u respektua nga operatorët.

Ky fenomen është evidentuar qartë, duke paraqitur edhe të dhëna të detajuara mbi mbulimin e realizuar nga çdo operator në përputhje me licencën dhe jashtë kushteve të saj. Në rezolutën e fundit që Parlamenti miratoi në lidhje me veprimtarinë e KKRT, pasi u evidentua si mangësi e punës së institucionit "mosndalimi në kohë i operatorëve të cilët kanë shkelur kushtet e parashikuara në licensat e tyre, lidhur me hapësirat e transmetimeve radio e televizive", u kërkua gjithashtu, në mënyrë eksplikite ndërhyrja më energjike në drejtim të rritjes së autoritetit të zbatimit të ligjit.

Në muajin Prill 2007, KKRT, pasi kishte përfunduar detajimin e Projekt Planit Kombëtar për Frekuencat Televizive (Analoge dhe Numerike) në letër, programoi inspektimet përmes përdorimin e spektrit të frekuencave në të gjithë Shqipërinë. Në respektim të kompetencave që i jep ligji, KKRT duke njojur situatën e operatorëve që transmetonin jashtë zonës së tyre të licencimit, përparrë nisjes së inspektimeve, paralajmëroi dhe kërkoi edhe njëherë nga të gjithë operatorët që, brenda datës 30.04.2007, të mbyllnin vullnetarisht të gjitha stacionet e instaluara pa leje, pasi në të kundërt do të ndërmerrreshin sanksionet e parashikuara në ligj.

Bazuar në urdhrin nr. 464 prot., datë 03.05.2007 të Kryetarit të KKRT-së filloj inspektimi i operatorëve që kishin instaluar impiante jashtë zonës së tyre të licencimit. Urdhri, krahas matjeve të spektrit, parashikonte edhe evidentimin e bllokimin e stacioneve të paautorizuara nga KKRT. Bllokimi i stacioneve të paautorizuara u krye nga grupe i inspektimit të përbërë nga inspektorët e Policisë Tatimore të mbështetur nga inspektorët e KKRT-së në bazë të urdhraleve të veçantë përmes pikë transmetimi që inspektohej.

Mbështetur në urdhrat e Kryetarit të KKRT-së nr. 42, datë 07.05.2007, nr. 43, datë 07.05.2007, nr. 44, datë 07.05.2007, nr. 45, datë 07.05.2007, nr. 46, datë 07.05.2007, nr. 47, datë 10.05.2007, nr. 49, datë 14.05.2007, nr. 51, datë 17.05.2007, nr. 60, datë 14.06.2007, nr. 63, datë 18.06.2007, nr. 71, datë 29.06.2007, nr. 77, datë 04.07.2007 dhe nr. 83, datë 20.07.2007, inspektorët e Policisë Tatimore dhe KKRT-së, realizuan bllokimin me vulosje të pajisjeve transmetuese të operatorëve të ndryshëm radiotelevizivë në pikat transmetuese Tarabosh, Kërcullë, Kodër Ishëm, Petresh, Zvërnec, që ishin instaluar jashtë zonave të tyre të licencimit.

Bazë ligjore e këtyre akteve ka qenë dhe mbetet neni 137/2 i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

*"Inspektorët bllokojnë dhe mbyllin me vulosje pajisjet, kur për përdorimin e tyre nuk është marrë licencë, kur ato nuk janë të miratuara ose kur nuk plotësohen kushtet e licencës.*

*Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit dhe më pas i jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit dhe subjektit të mësipërm, kalon në buxhetin e shtetit."*

Programi i parashikuar për matjet dhe bllokimin e pajisjeve ndeshi vështirësi zbatimi për shkak të pengesave dhe problemeve të shkaktuara nga debatet që krijoj mbyllja e stacioneve të palicencuara. Në shumë raste, operatorët që kishin instaluar stacione jashtë zonave të tyre të licencimit manifestuan mosbindje ndaj ligjit, duke vënë përsëri në punë stacionet e mbyllura ligjërisht nga inspektorët e Policisë Tatimore dhe KKRT-së.

Kjo bëri që grupet e inspektimit të rikthehen disa herë në disa pika të caktuara. Lufta ndaj këtij fenomeni të padëshiruar (rivënie në punë e transmetuesve pa leje), shkaktoi pauza relativisht të gjata në punën për matjen e spektrit të frekuencave. Në ndonjë rast, siç ishte rasti i pikës së Taraboshit apo i Kërcullës, përkrah shkelësve të ligjit u rreshtuan edhe autoritete shtetërore apo me imunitet. Ndërhyrja pa kriter e politikës, duke inkurajuar shkelësit e ligjit, solli pengesa të mëdha për vendosjen e autoritetit të ligjit nga ana e KKRT.

Pas ezaurimit të afateve të përcaktuara nga ligji, u konstatua që disa nga operatorët, pasi dhunuan vulat e vendosura nga inspektorët e Policisë Tatimore dhe KKRT-së, vazhduan transmetimet e paautorizuara duke mos e vlerësuar seriozitetin dhe vendosmërinë e KKRT për respektimin rigoroz të ligjit.

KKRT, vazhdoi me këmbëngulje punën e filluar, duke i përshkallëzuar masat në përputhje me dispozitat ligjore. Në këtë kuadër, KKRT mori vendimin unanim nr. 631, datë 08.10.2007, për kalimin në fazën e sekuestrimit të impianteve jashtë zonave të licencimit, bazuar në paragrafin e dytë të nenit 137/2 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 të përmendur më sipër.

Në zbatim të këtij vendimi, Policia Tatimore në bashkëpunim të ngushtë me inspektorët e KKRT-së, sekuestroi dhe dorëzoi në depot e rezervës së shtetit pajisjet si më poshtë:

| Pika e Transmetimit   | Impiante jashtë zonës së licensimit           | Data e sekuestrimit |
|-----------------------|---|---------------------|
| Kërcullë, Gjirokastër | Stacione ritransmetues të programeve :        | 15.10.2007          |
|                       | 1. NET<br>2. MEGA<br>3. ANT<br>4. ET1<br>5. A |                     |
| Petresh, Elbasan      | TV Vizion +<br>TV Telesport                   | 16.10.2007          |
| Zvërnec, Vlorë        | Koha TV                                       | 17.10.2007          |

Në arritjen e këtij rezultati një kontribut të veçantë dhe tejet të rëndësishëm ka pasur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si organi kompetent për zbatimin e urdhreve dhe vendimeve të KKRT-së, e cila ka treguar një vlerësim maksimal për të gjithë urdhrat dhe vendimet e nxjerra nga KKRT. Për zbatimin e këtyre urdhreve dhe vendimeve, ky institucion ka angazhuar forcat e Policisë Tatimore dhe në çdo moment ka shprehur gatishmërinë për të vepruar dhe me forcën mbështetëse me grupe punonjësish.

Në përfundim, duke parë edhe rezultatin e punës që nuk ka më impiante jashtë zonave të licensimit, vendimi nr. 631, datë 08.10.2007 i KKRT-së, pati një rezultat të kënaqshëm që u konkretizua në krijimin e hapësirave të lira në spektron e frekuencave televizive që do të përdoren për përmirësimin e mbulimeve të operatorëve kombëtarë e lokalë dhe për rregullimin e hapësirave të nevojshme për licensimet e platformave të para numerike.

KKRT angazhohet të vazhdojë punën në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me mbështetjen e të gjithë aktorëve të interesuar në fushën e veprimtarisë së saj, për të arritur objektivat ambicioze të vendosura.

Në rastin e mylljes së transmetimeve të palicencuara, KKRT ka trajtuar me kujdes të veçantë çështjen e përsëritësve të sinjaleve të disa programeve greke në Gjirokastër. Në mungesë të përcaktimit të saktë të frekuencave të lira, KKRT e kishte të vështirë licencimin e subjekteve te reja. Megjithatë, për vetë karakterin e veçantë të problemit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit është treguar i gatshëm dhe i hapur për të përcaktuar një zgjidhje të pranueshme për informimin dhe argëtimin e minoritetit Grek edhe me programe në gjuhën e tij amtare. Në këtë kontekst, të interesuarve u është paraqitur nga KKRT një zgjidhje që merr parasysh krijimin e hapësirave për informimin e argëtimin e minoritetit duke ruajtur raporte të barabarta dhe jo diskriminues me transmetimet e operatorëve

vendas të licencuar, përsëritësit e tjerë të sinjaleve të huaja dhe krijimit të hapësirave për transmetimet numerike. Gjithsesi KKRT ka bërë të qartë se numri prej 5 përsëritësh të programeve greke për zonën e Gjirokastrës rezulton i ekzagjeruar në kushtet kur dihet se ligji nr 8410, datë 30.09.1998 (Neni 129) përcakton:

"Instalimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve përsëritëse bëhet vetëm pasi është dhënë licenca përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

Në caktimin e kanaleve dhe frekuencave për përsëritësit kanë përparësi kërkesat për kanale dhe frekuencia të subjekteve publike e private të licencuara. (ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.7.2000)".

Caktimi i kanaleve dhe frekuencave për përsëritësit e stacioneve të huaja radiotelevizive bëhet duke respektuar përparësinë për transmetuesit ose përsëritësit e operatorëve radiotelevizivë vendas. (shtuar me ligjin nr. 8794, datë 10.5.2001)".

## ORGANIZIMI I GARËS PËR SHPALLJEN E OPERATORIT TË TRETË ANALOG KOMBËTAR

Mbyllja e transmetimeve jashtë zonave të licencimit lroi një numër kanalesh në të gjithë territorin e vendit duke krijuar kushtet për planifikimin e frekuencave për krijimin e një rrjeti të katërt analog kombëtar, në përgjigje të kërkesave dhe presioneve nga operatorë te ndryshëm për t'u shpallur operatorë kombëtarë. Bazuar në frekuencat, tashmë të identifikuara, KKRT organizoi konkursin e kandidaturave për operatorin e tretë privat kombëtar.

### Përzgjedhja e frekuencave për krijimin e rrjetit të IV Analog Kombëtar

Në zbatim të Vendimit nr. 627 Dt. 03.10.2007 të KKRT për shpalljen e garës per krijimin një operatori të tretë privat Kombëtar, D.Teknik, bazuar në punën për finalizimin e Planit të Frekuencave, identifikoi një numër frekuencash që mund të përdoreshin për të siguruar një mbulim kombëtar.

### Kriteret për identifikimin e kanaleve të lira për transmetime analoge

Një kanal televiziv u konsiderua i lirë për t'u përdorur për transmetime analoge në një pikë të dhënë transmetimi, kur:

- Nuk bën pjesë në kanalet e përcaktuara për përdorim numerik nga Marrëveshja GE06;
- Nuk përdoret për transmetime analoge në bazë të një licence të lëshuar rregullisht nga KKRT;
- Nuk përdoret për të mbuluar një zonë të dhënë shërbimi që mbulohet edhe nga një stacion tjetër i vendosur në një pikë tjetër transmetimi me pamje direkte me pikën e dhënë;

- Stacioni i akorduar në kanalin e dhënë nuk afekton stacionet e vendeve fqinjë të përfshira në gjendjen referencë të përcaktuar nga Marrëveshja GE06;
- Në pikën e dhënë të transmetimit është plotësuar numri i kanaleve të lira të nevojshëm për migrimin e kanaleve analoge që do të lirojnë vendin për transmetimet numerike.
- Në pikën e dhënë nuk ekziston ndonjë stacion që transmeton sinjale analoge në kanalet fqinjë me kanalin e dhënë. Në rastet kur një kriter i tillë nuk mund të plotësohet, përdorimi i kanalit fqinjë do të planifikohet, me rezervën që KKRT mund ta ndryshojë atë në fazën e implementimit, nëse shkaktohen interferenca të dëmshme tek kanalet ekzistues.

### Përzgjedhja e kanaleve

Përzgjedhja e kanaleve për krijimin e Rrjetit IV analog kombëtar u realizua mbështetur në kriteret e përcaktuara më sipër. Bashkëngjitur jepen kanalet e caktuara në pikat përkatëse të transmetimit të shpërndara në territorin e vendit.

Theksojmë se përzgjedhja e kanaleve u realizua bazuar në të dhënat e Data Bases së DT si dhe në të dhënat e RRC Planning Software të ITU. Matjet në terren, të realizuara në zonën e Shkodrës, Lezhës, Ishmit, Gjirokastër vërtetuan se ekzistojnë shhangje nga këto të dhëna, si për stacionet e operatorëve vendas, ashtu edhe për sinjalet e programeve të huaja që afektojnë zonat shqiptare. Kjo gjendje nuk jepte garanci se planifikimi i kanaleve për rrjetin e katërt analog do të siguronte kudo cilësinë e kërkuar. Prandaj Drejtorisë Teknikë i u la një shkallë e nevojëshme fleksibiliteti, për të bërë ndryshimet përkatëse të planit, gjatë periudhës së implementimit.

Vështirësia më e madhe u përballet gjatë caktimit të frekuencave në pikën e transmetimit te malit te Dajtit dhe atë të Ardenicës, që janë pikat më të ngarkuara. Edhe në këtë rast rezultoi i nevojshëm lehtësimi i kritereve të aplikuara duke ruajtur të drejtën për ndryshime në fazën e implementimit.

Pas përzgjedhjes së kanaleve, bazuar në standartet e mbulimit për transmetimet televizive analoge me 625 rreshta në brezin UHF (Rec. ITU-R BT.1123), u llogarit mbulimi i territorit shqiptar i realizuar nga stacionet transmetues të Rrjetit, të instaluar në të gjitha pikat e transmetimit.

### Rezultatet e Garës

Gara për operatorin e tretë privat Kombëtar u shpall në datën 14 Tetor 2007 nëpërmjet mjeteve të informimit publik. Subjekteve që kishin shprehur interesin, njoftej i u bë me anë të shkresave të veçanta.

Aplikimet u térhoqën nga 3 subjekte. Në konkurrim u paraqitën me dokumentacion të përgatitur 2 subjekte: Tv Top Channel dhe TV Vizioni+. Hapja e

dokumentave u realizua në datën 15 Nëntor 2007. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni i vlerësimit i paraqiti Këshillit rezultatet duke propozuar shpalljen fitues të operatorit Top Channel. Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2008 Këshilli Kombëtar vendosi t'i japë subjektit të mësipërm licencën si operator privat kombëtar.

#### *4.5 Puna përfundimin e planit të frekuencave*

“Gjithashtu, autoritetet shqiptare duhet të përbledhin diskutimet mbi projekt-strategjinë për zhvillimin e transmetimeve televizive dhe te finalizojnë Planin Kombëtar të Radios dhe Televizonit” (Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2005).

Gjatë vittit 2007 prioriteti kryesor i KKRT ka qenë puna intensive përfundimin e Planit të Frekuencave, me qellim hapjen e rrugës përfillimin e licencimit të transmetimeve numerike. Siç është raportuar më parë, fazat e punës përgatitore dhe hartimi i projekt planit të koordinuar me vendet e tjera të rajonit brenda distancës së koordinimit prej 1000 km, që kanë të bëjnë me probleme teknike të planifikimit, janë zbatuar nga KKRT për një periudhë 3 vjeçare (Para, gjatë dhe pas GE06) në bashkëpunim të ngushtë me vendet e rajonit të planifikimit dhe nën udhëheqjen teknike të drejtpërdrejtë nga ITU (BR-Byroja e Radiokomunikacioneve).

Kjo fazë i përket kryesisht hartimit të Planit Numerik bazuar në parametrat dhe karakteristikat e miratuara nga dokumentet e RRC04 dhe RRC06 si dhe koordinimit të tij me vendet fqinjë. Me fiksimin e planeve (Analog dhe Numerik) pas 16 Qershorit 2006, u krye azhornimi me gjendjen ekzistuese të Shqipërisë dhe u përgatit Projekt Plani. Për këto faza të zhvillimit të planit të frekuencave është raportuar me hollësi në Raportin **“Përshkrimi i veprimtarisë së grupit përfaqësues të KKRT në sesionin II të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve (RRC-06)”**, paraqitur nga KKRT edhe në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të informimit Publik të Kuvendit të Shqipërisë.

Pas përfundimit të detajimit të planit në letër, nga Kryetari i KKRT u lëshua urdhri nr.464 prot. i datës 03.05.2007 përfundimin e matjeve në terren ku u përcaktua **plani përkatës i matjeve të shfrytëzimit të spektrit**. Por, siç u trajtua me lart, programi i parashikuar përfundimin e matjeve hasi vështirësi zbatimi për shkak të pengesave dhe problemeve të shkaktuara nga debatet që ka krijuar mbyllja e stacioneve të palicencuara.

Mungesat e gjata të energjisë elektrike në zona të ndryshme, krijuan një problem serioz shtesë përfundimin e matjeve dhe zbatimin në kohë të grafikut të përcaktuar.

KKRT ishte e bindur se pa u fiksuar gjendja, pa u përcaktuar stacionet që do të janë në punë dhe pa u përcaktuar me saktësi kanalet e lira e të pa interferuara nga stacionet vendas dhe të huaj, ishte e pamundur të përcaktohet plani si dhe **strategjia** për përbushjen e tij.

Nëse nuk ka siguri në mbajtjen e një regjimi të caktuar në administrimin e spektrit, nuk mund të pretendohet të hartohet një grafik i saktë i krijimit të hapësirave për transmetimet numerike, që përbën bazën e planit të Migrimit. Siç u përmend më sipër, me disiplinimin dhe vënien nën kontroll të transmetimeve, është krijuar siguria që kërkon licencsimi i shërbimeve të reja numerike.

### **Korrektimi i të dhënave në letër**

Me përfundimin e korrektimit të të dhënave, KKRT tashmë ka përcaktuar:

**Numrin e kanaleve aktualisht të lira për transmetime numerike, dhe Planin e Migrimit të kanaleve Analogë për lirimin e kanaleve të caktuara për transmetime numerike.** Këtu përfshihet dhe përcaktimi i numrit të rrjeteve numerike që mund të krijohen në momentin e parë. Nga vrojtimi i okupimit të spektrit në zonën me të ngarkuar Tirane-Durrës, rezulton se në brezin UHF ekzistojnë mundësítë për të vënë në dispozicion të transmetimeve numerike tre kanale nga ato të planifikuara për transmetime numerike, pa pasur nevojë për transferime kanalesh. Bazuar në këto të dhëna tashme mund të gjyket e të përgatitet një propozim i bazuar mbi numrin e rrjeteve numerike kombëtare e lokale që mund të krijohen bazuar në një plan të përcaktuar kohor, në mënyrë që të arrihet objktivi që në vitin 2012 të janë krijuar të gjitha mbulimet kombëtare dhe lokale që parashikon marrëveshja GE06 për Shqipërinë. Ky plan do të jetë gati me përfundimin e **Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike**.

**Numrin e kanaleve analoge të lira** për tu përdorur nga operatoret lokale e kombëtarë deri në përfundim të periudhës së tranzisionit. Kujtojmë se, KKRT duhet të sigurojë

- Frekuencat për plotësimin e rrjetit për programin e dytë të RTSH;
- Frekuencat për plotësimin e mbulimit të dy operatorëve analogë Kombëtarë;
- Frekuencat për plotësimin e mbulimit të disa operatorëve rajonalë ekzistues.

Përveç këtyre, me shpalljen e garës së operatorit të tretë kombëtar, që u fitua nga TV Top Channel, u okupua një numër i konsiderueshëm frekuencash, që ndikoi në bilancin e përgjithshëm të tyre.

Në përcaktimin e frekuencave të lira analoge, problemi qëndron **në dhënien për përdorim të caktimeve të reja frekuencore analoge**. Në kuptimin e nenit 12 te Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacionit për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesët e Rajoneve 1 dhe 3, në

bandat e frekuencës 174-230 MHz dhe 470-862MHz (RRC-06), edhe nëse ekzistojnë frekuanca të lira, okupimi i të cilave mund të realizohet në bazë të standardeve teknike, Shqipëria **nuk lejohet** t'i futë ato në shfrytëzim pasi nuk figurojnë në plan, nuk kanë qenë në shfrytëzim në ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes GE06 dhe nuk është marrë miratimi nga vendet fqinjë.

Prandaj gjatë hartimit të planit të migrimit, është pasur parasysh të operohet me frekuencia që kanë qenë në shfrytëzim deri në momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. **Kjo krijoj një kufizim shtesë në përdorimin e kanaleve analoge gjatë periudhës së tranzicionit.**

Për përdorimin e frekuencave të reja duhet të ndiqen procedurat e modifikimit të planit dhe notifikimit siç përcaktohen në nenet 4 dhe 5 të Marrëveshjes GE06. Në kushtet aktuale, nën perspektiven e kalimit në transmetimet numerike, modifikimi i planit analog është një proces shume i vështirë, në mos i pamundur, pasi, që të notifikohet në MIFR, kërkon miratimin e të gjitha vendeve brenda distancës së koordinimit (1000 km), të cilat, siç e tregoi eksperienca e punës për regjistrimin e gjendjes reference, janë të prirura të mos e japid këtë miratim.

Pas përcaktimit të frekuencave të lira (Numerike e Analogë) KKRT është duke kryer llogaritjet radio elektrike për të përcaktuar parametrat optimale të të gjitha stacionet e planikuara të instalohen në të gjitha pikat e transmetimit me qëllim që të sigurohen transmetime cilësore brenda standardeve teknike dhe të garantonë që stacionet transmetuese të planikuara të mos shkaktojnë interferencë tek stacionet e tjera ekzistues, vendas apo të huaj duke qenë të mbrojtur nga interferencat shkaktuar nga stacionet vendase apo të huaja.

Këto llogaritje janë të komplikuara dhe kërkojnë kohë pasi parashikohet të kryhen disa seri llogaritjesh me parametra te korrektuar perderisa te arrihen parametrat optimale.

#### *4.6 Miratimi i strategjisë të transmetimeve numerike*

Për të siguruar një zhvillim gradual, të balancuar e të harmonizuar të transmetimeve televizive në vend, KKRT ka programuar me kohë përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit të transmetimeve RTV, në bashkëpunim me organizma të tjera shtetërore, organizma ndërkombëtare të specializuara dhe shoqatat e operatorëve. Neni 85, pika 2 e draft tekstit për negocimin e marrëveshjes së Stabilizim Asocimit midis Shqipërisë dhe EU, përcakton:

*“Do të projektohen Politika dhe masa të tjera për të sjelle zhvillimin ekonomik e social të Shqipërisë.”*

ndërsa pika 3 e po këtij nenit:

*"Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kuadër bashkëpunimi rajonal. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet masave që mund të nxitin bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinjë, përfshirë shtetet Anëtarë, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Këshilli i Stabilizim-Asocimit mund të përcaktojë prioritetet midis dhe brenda politikave të bashkëpunimit të përshkruara këtu".*

Në kuadrin e përpilimit të Strategjisë, KKRT ka nënshkruar me Zyrën e Pranisë së OSBE në Tiranë një Memorandum Bashkëpunimi. Në zbatim të këtij Memorandumi, pranë KKRT është atashuar një ekspert francez, i cili është duke asistuar KKRT në hartimin e një strategjie në përputhje me standarde dhe praktikat më të mira evropiane, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në problemet që mund të lindin nga kalimi nga sistemi analog në atë numerik.

Në mënyrë të përbledhur problemet kryesore që do të trajtojë strategjia e kalimit në transmetimet numerike, që kërkojnë edhe konsultim publik, janë:

- Mundësitë e shfrytëzimit të kapaciteteve teknike të transmetimeve televizive numerike tokësore në Shqipëri;
- Pjesa e spektrit që duhet të rezervohet për transmetimet televizive kombëtare vendore e rajonale;
- Prioritetet e ndërtimit të rrjeteve numerike (publike, private) dhe planifikimi i rendit të mbulimit të zonave gjeografike;
- Masat nxitëse për kalimin në numerik;
- Indikatorët që do të përcaktojnë mbylljen e transmetimeve analoge;
- Masat përmbrrojtjen e konsumatorëve;
- Masat përballimin e kostove të rishpërndarjes së frekuencave ;
- Standardizimi i pajisjeve dhe programeve të aksesit të kushtëzuar;
- Organizimi e bashkërendimi i palëve të interesuara për kalimin në numerik;
- Përfshirja e operatorëve ekzistues në procesin e kalimit ne numerik, etj.

### Llogaritjet radioelektrike për mbulimin dhe interferencat

Llogaritjet radioelektrike përbëjnë një proces të ndërlikuar e me përgjegjësi, pasi kanë të bëjnë me përcaktimin përfundimtar të parametrave radioelektrikë të secilit nga stacionet e planifikuara për t'u futur në shfrytëzim. Për të gjitha stacionet e futur në database, nëpërmjet software-it ICS Telecom do të llogaritet mbulimi me sinjal dhe interferencat që krijohen nga stacioni i marrë në shqyrtim tek të gjithë stacionet e tjera dhe anasjelltas, nga të gjithë stacionet e tjera tek stacioni i marrë në shqyrtim.

Në rast se rezultatet e llogaritjes janë negative do të bëhen korrektimet përkatëse të parametrave (ERP, diagrama e antenave) dhe do të ripërsëriten llogaritjet deri sa rezultati të jetë i pranueshëm nga pikëpamja e arritjes së objektivave të mbulimit dhe mbrojtjes nga interferencat e dëmshme. Vetëm pas përfundimit me sukses te llogaritjeve radioelektrike, mund të fillojnë procedurat e modifikimit të planit dhe notifikimit.

Procedurat e modifikimit dhe notifikimit të planit GE06:

- 1. Për caktimet Numerike**
- 2. Për caktimet Analogë**

Me përfundimin e llogaritjeve radioelektrike mbetet të realizohet procedura e modifikimit të planit dhe e notifikimit të caktimeve frekuencore për transmetimet numerike dhe analoge.

### **Për transmetimet numerike**


#### Modifikimi

Vendet e rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Greqi, Maqedoni, Bullgari, Rumani, Turqi, Mali i Zi, Serbi), duke respektuar marrëveshjen midis tyre (me përjashtim të Serbisë dhe Malit të Zi) në planin numerik kanë të miratuar vetëm allotmente. Për futjen në përdorim të planit, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 4 të Marrëveshjes, duhet të realizohet modifikimi i tipit "Shtimi i një caktimi që rrjedh nga një allotment i Planit Numerik". Për këtë tip modifikimi mund të aplikohet procedura e shpejtë për konvertimin e allotmentit në një apo më shumë caktime numerike (neni 4). Nëse BR i gjen karakteristikat në përputhje me kriteret e vendosura, kjo procedurë zgjat 30 ditë. Për këtë lloj modifikimi nuk është e nevojshme të kryhen procedurat e koordinimit, pasi allotmentet janë koordinuar paraprakisht. **BR ka njoftuar se të gjitha veprimet për të realizuar këtë modifikim do të bëhen në formë elektronike nëpërmjet një programi të përgatitur enkas për këtë qëllim.**

KKRT është në bashkëpunim të përhershëm me BR për të përfunduar sa më shpejt këtë proces.

#### Notifikimi

Me qëllim që të regjistrohet një Caktim që rrjedh nga një allotment, neni 5 i Marrëveshjes përcakton të ndiqet procedura e përshkruar në diagramën GE06-7 më poshtë:

**Procedurat e Nenit 5****(Transmetimi)**

\*Administratë mund të riparohet se dpa e 5.1.6 (dilët diagrammen GE06-10)

Sic shihet procedura kërkon disa verifikime që nuk varen krejtësisht nga administrata shqiptare. Në këtë rast KKRT mund të kontrollojë vetëm korrektesën e të dhënavë që dërgohen për notifikim. Për këtë procedurë nuk mund të vendosen afate, pasi në proces përfshihen edhe administratat e tjera të huaja, përfshirë edhe administratën e ITU (BR). Procedura ka dy përfundime: Kur gjetja është e favoroshme (janë plotësuar kërkesat, janë marrë të gjitha miratimet nga vendet fqinjë), caktimi regjistrohet në MIFR. Kur gjetja është e pafavorshme,

njoftimi i kthehet Administratës kërkuese e cila ka të drejtë ta ripërsërisë edhe një herë.

Nga sa u trajtua më sipër, nuk mund të përcaktohet një kohë e saktë përfundimin e këtij procesi. Sidoqoftë, për caktimet numerike që burojnë nga një allotment, nuk parashikohen vështirësi dhe vonesa të mëdha në regjistrim. Por duke qenë se jo të gjitha kanalet e përcaktuara për transmetime numerike janë të lira, procedurat e modifikimit të planit dhe notifikimit të tyre nuk do të fillojnë në të njëjtën kohë, por sipas grafikut që do të përcaktohet nga Plani i Migrimit i cili nga ana e tij do të varet nga **Strategjia** e zgjedhur e kalimit në transmetime numerike.

### Për transmetimet Analog

#### Modifikimi


Në gjendjen referencë analoge të GE06 për Shqipërinë rezultojnë vetëm 4 caktime frekuencore analoge të trashëguara nga marrëveshja ST61. Të gjitha caktimet e tjera përfshirë caktimet në përdorim të stacioneve transmetues ekzistues, nuk figurojnë në gjendjen referencë. Bazuar në pikën 12.2 të Akteve Finale të RRC06:

“Që nga data e përmendur në § 12.2 të mësipërm, stacionet e transmetimit që operojnë me caktimet frekuencore që nuk përbahen në *Plane apo* që nuk janë në pajtim me *Marrëveshjen* dhe *Planet* e saj përkatës (shih § 5.1.2 e Nenit 5) mund të vazhdojnë të operohen në rrethanat e mos-shkaktimit të ndërhyrjeve të papranueshme, dhe nëse nuk kërkojnë mbrojtje nga çdo caktim në pajtim me *Marrëveshjen* dhe *Planet* e saj përkatëse.”

Në interpretim të kësaj pikë, caktimet frekuencore në përdorim mund të vazhdojnë operimin. Në këtë kuptim KKRT, gjatë hartimit të planit të Migrimit mund të përdorë frekuencat tashmë të okupuara nga stacionet ekzistues, me të njëjtit karakteristika për të mos shkaktuar interferencë shtesë që mund të çojnë në shfaqjen e ankesave nga vendet fqinjë.

Duhet pasur parasysh se lejimi i operimit të këtyre caktimeve frekuencore mund të përdorët për të shmangur procedurën e modifikimit të planit, por kjo nuk parakupton regjistrimin në MIFR.

Për caktimet që nuk kanë qenë në përdorim ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, KKRT duhet të aplikojë procedurat e përcaktuara në nenit 4 (paragrafi 4.1.1 a)b)) të Marrëveshjes. Për këtë qëllim duhet të realizohet modifikimi i tipit “Shtesa/ ndryshimi i caktimit/allotmentit”. Procedura e modifikimit përshkruhet në diagramën e mëposhtme (Diagrama GE06-2):




Sic shihet, diagrama është e komplikuar dhe në fund procedura mund të rezultojë e suksesshme por edhe e pasuksesshme kur mungon dëshira e vendeve që ndodhen brenda distancës së koordinimit për të dhënë pëlgimin e tyre. Me një fenomen të tillë KKRT është përballur edhe në periudhën midis dy sesioneve të RRC (RRC04-RRC06) kur u përpooq pa sukses të përfshinte në gjendjen referencë rreth 300 caktime frekuencore analoge.

Në rastin më të keq, procedura e një modifikimi të suksesshëm zgjat 245 ditë nga dita kur njoftimi arrin në BR. Në rastin e zakonshëm kohëzgjatja zakonisht është 175 ditë. Nga pikëpamja optimiste, nëse një Administratë jep të gjithë informacionin e kërkuar në §4.1.2.5 koha me e shkurtër do të jetë 110 (40 +40 +30) ditë apo më pak prej datës së marrjes së njoftimit nga BR.

### Notifikimi

Notifikimi i caktimeve Analogë tregohet në diagramën e mëposhtme (GE06-6) dhe bëhet sipas procedurave të përcaktuara në paragrafin 5.1.2 a)b).



Sic shihet nga diagrama, sa po konstatohet që nuk bën pjesë në Plan (rombi i parë) njoftimi kthehet tek Administrata origjinë me cilësimin negativ. Për të arritur që një caktim analog të regjistrohet në MIFR, ai duhet të bëjë pjesë në Planin Analog.

KKRT do të bëjë të gjitha përpjekjet, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e ITU (BR) si dhe duke intensifikuar koordinimin me fqinjët për të shfrytëzuar të gjitha mundësítë përritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të spektrit.

Kushti kryesor për një koordinim të suksesshëm me strukturat e ITU dhe administratat e vendeve fqinjë është stabiliteti në shfrytëzimin e spektrit që do të thotë dhe marrja e përgjegjësive për zbatimin e ligjeve të vendit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, duke forcuar autoritetin e KKRT, sidomos në zgjidhje përfundimtare të transmetimeve të pa licencuara. Në këtë kontekst, suksesi i arritur nga KKRT gjatë vitit 2007 në disiplinimin e shfrytëzimin e spektrit të kufizuar të frekuencave, përbën një bazë të fuqishme për të siguruar zhvillimin normal të rrjeteve numerike në Shqipëri.

## 5 BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË


### 5.1 Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Treguesit finansiarë për vitin 2007, janë miratuar sipas strukturës si më poshtë:

|                                      | Në milion lekë |
|--------------------------------------|----------------|
| Të ardhura të krijuara në vitin 2007 | 48             |
| Përdorim të ardhura nga gjendja      | 46.3           |
| Shpenzime korrente                   | 66             |
| Shpenzime për Investime              | 28.3           |

#### a. Burimi i financimit


- **Burimet e financimit të të Ardhurave janë sipas strukturës së miratuar:**



- Burimet e financimit të shpenzimeve për vitin 2007 janë të ardhurat të cilat do të realizohen në vitin 2007 sipas planit të miratuar si dhe të ardhurat e realizuara dhe të trashëguara nga vitet e mëparshme.

#### b. Realizimi i treguesve finansiarë - TË ARDHURAT


Në planin finansiar të miratuar për vitin 2007, është parashikuar të sigurohen të ardhura vjetore në shumën prej 48 milion lekë. Realizimi i këtij treguesi, në vlerën prej 39.055 milion lekë pasqyrohet si më poshtë:



Pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen e licencës.


Burimi kryesor i të Ardhurave, ose rreth 94 % e tyre, janë pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen dhe rinovimin e licencës. Këto pagesa shlyhen nga operatorët radiotelevizivë të cilët operojnë në fushën e mediave elektronike.

- Për vitin 2007 pjesëmarra në aktivitetin radioteleviziv pasqyrohet:




Të ardhurat e parashikuara në formën e pagesave për licensë për vitin 2007, të detajuara sipas zonave në të cilat operojnë operatorët si dhe sipas llojit të licencave që ata kanë, paraqiten:


- Nga operatorët Radio FM




- Nga operatorët TV



- Nga operatorët TV kabllorë



Në vitin 2007, janë realizuar 26. 91 milion lekë të ardhura nga pagesat për licencë të vitiit 2007 ose rreth 63% e parashikimit.



Mbi 92% e operatorëve radio FM kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licencë në shumën prej rreth 4.6 milion lekë ose rreth 73%.

Rreth 70% e numrit të operatorëve TV me frekuencë kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licencë në shumën prej rreth 17 milion lekë ose rreth 68%.

Rreth 76% e numrit të operatorëve TV me kabell kanë shlyer detyrimet e pagesave vjetore për licence në shumën prej rreth 5.5 milion lekë ose rreth 47%.

Në këtë përqindje realizimi ka ndikuar mos pagimi i detyrimeve financiare nga ana e operatorëve, detyrimet vjetore të të cilëve kanë peshë të madhe në totalin e detyrimeve. Operatorët "TV kombëtar Klan", "Radio kombëtare +2", TV me kabell të qytetit të Tiranës si "TV me kabell DCN", "TV me kabell Alfa", "TV me kabell Star", detyrimet e të cilëve përfaqësojnë 25.7 % të pagesave vjetore për licencë, janë aktualisht debitorë ndaj KKRT.

Bashkëngjitur ndodhen tabelat analitike të shlyerjes së detyrimeve të pagesave për licencë nga operatorët RTV për vitin 2007 deri më 25.1.2008.

- Pagesa vjetore e licencës, diferenca nga viti 2006

Në pagesat e mbartura nga viti paraardhës dallojmë dy momente:

Pagesat të cilat faturohen në vitin paraardhës por paguhen në vitin pasardhës, nisur nga fakti që pagesa vjetore për licencë llogaritet për vit licencimi.

Pagesat të cilat i përkasin vitit paraardhës por që nuk janë shlyer nga operatorët.


Në rastin e dytë, operatorët merren në konsideratë nga KKRT, duke marrë masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës.

Shuma e pagesave të mbartura nga viti 2006 dhe të arkëtuara në vitin 2007 është 8. 77 milion lekë.

- Të ardhurat nga agjenti tatimor – Taksat për shërbimet RTV

Në mbështetje të dispozitave ligjore për sistemin e taksave, Institucioni ynë në rolin e agjentit tatimor derdh në buxhetin e shtetit taksën vjetore të subjekteve RTV, e cila vilet për llogari të Tatim Taksave. Për këtë KKRT përfiton 5 përqind të vlerës së derdhur në buxhetin e shtetit.

Numri i operatorëve të cilët derdhin taksat për shërbime radio televizive është:



Mbi 92% e operatorëve radio FM kanë shlyer detyrimet e taksave për frekuencë në shumën prej rreth 1.5 milion lekë ose rreth 89.3%.

Rreth 73% e numrit të operatorëve TV me frekuencë kanë shlyer detyrimet e taksave për frekuencë në shumën prej rreth 8.2 milion lekë ose rreth 67%.

Detyrimi i taksave të operatorëve kombëtarë "TV Klan" dhe "Radio +2", i cili përfaqëson rreth 12% të detyrimit total të taksave, aktualisht nuk është shlyer, duke ndikuar në masën e realizimit të këtij treguesi.

Për vitin 2007 janë derdhur në buxhetin e shtetit 17.1 milion lekë, ndërsa janë përfituar 0.79 milion lekë nga KKRT, si agjent tatimor.


